



Viti i njëmbëdhjetë i botimit, Mujore, Nr.5 (133) Prill 2010  
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA  
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

# Njëmbëdhjetë vjet më parë...

Kështu nisi rrugën gazeta e thjeshtë, pa shumë pretendime, po me emrin e rëndë "Mokra". Flori Slatina, Haki Balliu, Llazi Tona, Fahri Muço, Zabit Çuku, Zenun Fero etj e nisën rrugën e gazetës, thjesht deshën të lehtësonin shpirtin e tyre nga brenga e largimit prej vendlindjes së dashur. Pas punës së lodhshme të ditës, pas problemeve jo të vogla të jetesës në Tiranë, qëmtonin atë pjesëzën e kohës së lumtur të shkruanin për bukuritë e vendit të tyre, për historinë e largët e të afërt, për këngët dhe veshjet e burrave e grave, për politikën e ditës dhe nevojat e zhvillimit të Mokrës.



## Festohet në Pogradec

### 11-vjetori i gazetës "Mokra,"

Më 27 mars u festua në Pogradec 11 vjetori i gazetës "Mokra," e lindur më 25 mars 1999

Jemi mbledhur sot së toku për të festuar një ngjarje të madhe, përvjetorin e daljes së numurit të parë të gazetës "Mokra". Njëmbëdhjetë vjet më parë një grup i vogël mokrarrësh

të larguar në Tiranë vendosën të nxjerrin një gazetë ku të derdhnin mallin e tyre për vendlindjen. Asnjëherë nuk jemi mbledhur në këto përmasa këtu në Pogradec. Shpresoj

që në të ardhmen takime të tilla mokrarrësh të jenë të shpeshta.

Mallin e vendlindjes e ndjen deri në thellësi të shpirtit vetëm ai që largohet për një kohë të gjatë prej saj. Në vrundullin e punëve të përditshme, hallevë dhe telasheve të jetës gjen kohë të kthejë kokën pas, të meditojë, të përjetojë copëza të harruara diku në thellësi të kujtesës derisa lot dertesh i rrëshqasin lehtësisht nëpër faqe. (vijon fq. 2)

## DINAKËRA GREKE DHE INDIFERENCA E TROJANËVE!

Rreziku i përbashkët i bashkon njerëzit - Grim

**S**a herë që ndodh ndonjë gjë me Shqipërinë ose shqiptarët të cilët robtohen në Greqi, politika vendase ose qeverisëse përmend: miqësinë e fqinjësisë së mirë midis dy popujve. Po përmendim disa data pas të ashtuquajturës përmbyseje të komunizmit. Në vitin 1993 në zonën e Gjirokastrës vepronte i pa emëruar arkimandriti grek, Kristo Sanas i cili kishte lënë mënjani punët e fesë dhe shtronte herë pas here bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë. Ai shpërndante libra antishqiptarë të Sebastianos, flamuj grekë dhe bënte thirrje të hapura kundër vendit tonë. Shteti shqiptar vazhdonte me sloganin: "Fqinjësia e mirë me marrëdhënie të shkëlqyera". Po në vitin 1994, pesë priftërinj grekë shpërndanë postera të "vorio-epirit" dhe bënë propagandë politike. Shtetarët shqiptarë përsëri thoshin: "fqinjësia e mirë". Grekët përfituan edhe në dhënien e tapive falas në jug te vendit, pasi dihet se minoriteti grek nuk është autokton, por të ardhur për të punuar si bujq te bejlerët e Gjirokastrës dhe u bënë pronarë me ndihmën e ligjit 7501 për tokën i cili ia dha tokën atij që e punon dhe jo atij që i ka në pronësi. "Kanë shumë të drejtë" të thonë se janë autoktonë, "pronarë në tokat e tyre".

Dhe në agresionin e hapur kur u vranë pesë ushtarakët tanë nga forcat ushtarake greke, qeveria shqiptare heshti përsëri, u tregua tolerante. Në revolucionin e armatosur komunist të 1997-ës, ata që udhëhoqën dhe ngritën flamurin grek në tokën shqiptare në vend që të shkonin prapa hekurave, u shpërblyen dhe u pasuruan në mënyrë të tmerrshme. Kemi rastin e tifozllëkut në ndeshjen e futbollit Shqipëri-Greqi e cila u zhvillua në Athinë, grekët vranë të riun nga Kukësi i që duartrokiste dhe festonte fitoren e shqiptarëve, përsëri shteti dashur. Në prill të vitit 2006 në Kosinë të Përmetit u shkatërruan varrezat e fshatit nga prifti Vasil Thomollari i cili paguante punëtorët shqiptarë. Shkak për denoncimin e këtyre gërmimeve të fshehta dhe të kësaj prapaskene u bë pagesa e punëtorit Altin Ballabani i cili shkoi në prokurori. Si gjithnjë, prokuroria shqiptare për të mos prishur marrëdhëniet "e fqinjësisë së mirë" e mbylli edhe këtë çështje si të parëndësishme. Grekët kanë bërë me ne çfarë kanë dashur. Kanë ngritur kisha ku u është tekur dhe sa kanë dashur, madje edhe brenda oborrit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Janë përsëri grekët që kanë ngritur varreza të ushtarëve të tyre në disa vende të Shqipërisë pa lejen e shtetit shqiptar. Parlamenti ynë e ka aprovuar këtë truall varrezë pa ia kërkuar greku. Janë të shumta parcelat e ligjëruara për varreza veçse ushtarë të vranë grek nuk ka aq sa thuhet. Grekëve lëshime u janë bërë dhe u bëhen gjithë këto në emër të "fqinjësisë së mirë", paçka se ata mbajnë kallashin në dorë për shqiptarët që marrin malet për një copë bukë dhe qeveria përsëri hesht! Në vitin 2007 ushtarët grekë kënduan në kor për zorrët e shqiptarëve dhe përsëri u hesht! Dhe ja, para disa ditësh me rastin e çlirimit të Greqisë parada e ushtarëve dhe oficerëve grekë bënë të njëjtën gjë me shqiptarët. Ilir Meta tha dy fjalë, por jo ato që duheshin. Ky Ilir, ky zbulues i madh i cili deklaroi se ka minoritet serb në Shqipëri. Këtë çmenduri as vetë serbët se kanë thënë ndonjëherë. Iliri e quajti këtë vizitë të suksesshme edhe pse serbët e hoqën flamurin shqiptar kur ai ishte në Preshevë. Mendoj se ndoshta ishte kjo që nxiti xhelozinë greke të ditëve të fundit. Ndoshta grekët mendojnë se pas kësaj Ilir Meta do të përmendë edhe çamët e dëbuar barbarisht nga trojet e tyre, por dihet se diplomacia shqiptare as e ka bërë dhe as do ta bëjë këtë gabim.

Së fundi, më duhet t'u përmend fatin e Kokës së Laokoontit të rrethuar nga gjarpërinjtë e cila brendë nga muzeu në muze për t'u kujtuar të gjithë bashkëkohësve të këtij shekulli misterin e pushimit të Trojës, dinakërinë greke, por mbi të gjitha, indiferencën e trojanëve!

Bedri BLOSHMI

## Petraq Pekmezi, "Nder i Kombit"

Nga Koço PIHONI



Në Velcan, atje ku denoncohet çdo ditë trishtimi

Dy të vërteta që i mbuloi me dhé diktatori në 4 prill 1944

Nga Eqerem KALANXHI



## Dasmë mokrare me saze

Nga Tomi MATO

"NOBELISTI," BUJAR BALLIU VLERËSON NOBELISTËT E LETËRSISË

"Bari i ujkut" promovohet në shkollën e mesme Starovë





# Festohet 11-vjetori i gazetës "Mokra,"

Më 27 mars u festua në Pogradec 11 vjetori i gazetës "Mokra," numri i parë i së cilës doli më 25 mars 1999

Një ceremoni e veçantë, krejt ndryshe nga më parë, është zhvilluar buzë liqenit të Pogradecit, në gjirin e mokrarëve, me rastin e 11-vjetorit të galjes së numrit të parë të gazetës "Mokra". Ishte ftesa e sinqertë dhe bujare e n/kryetarit të shoqatës "Pelioni" dhe njëherësh e gazetarit dhe shkrimtarit Istref Haxhillari që këtë përvjetor ta festonim në Pogradec, pranë mokrarëve, miqve dhe dashamirësve tanë.

Përvjetori 11-të i gazetës "Mokra," ishte një ngjarje e veçantë. Pas përvjetorit të dhjetë të shoqatës "Pelioni," me takime dhe aktivitete të plot mbresa dhe kujtime në dashamirësit e Mokrës dhe më gjërë, ky është takimi i dytë i përvitshëm dhe shumë i rëndësishëm. Festa e ka zanafillën pikërisht në festimin e 10-vjetorit në Tiranë, në muajin dhjetor. Me me propozimin e degës së shoqatës "Pelioni", në Pogradec u vendos që ky përvjetor të organizohet dhe festohet me një pjesëmarrje më të gjërë në Pogradec. Kjo u mirëprit me shumë kënaqësi nga shume mokrarë. Kjo duhet thënë që në fillim se organizimi, masat e marra nga pritësit që e përkryer, e mrekullueshme, e nuk mund të thuash gjë përveç vlerave dhe vlerësimeve maksimale nga organizatorët Istref Haxhillari, Bujar Balliu e tjerë.

Takimi dhe mirëseardhja më 27 mars ishte caktuar te sheshi kryesor i qytetit. Organizatori Istref Haxhillari dhe Bujar Balliu kishin marre masa ditë më përpara. Maliq Torra kishite zbritur nga Velçani, grupi i Tiranës ishte nisur dhe nëpërmjet telefonave ishin në kontakt për festën e bukur. Pritjet dhe takimet ishin të përzemërta e shumë miqësore. U shpërndanë gazeta të radhës dhe takimi u përqëndrua tek lokali "Mokra" i Nazar Haxhillarit, i cili me buzëqeshje dhe me atë mikpritjen uronte mirseardhjen me gotat e rakisë në tavolinë.

Kur takuam Istrefin ishte shumë i shqetësuar jo për një, por çdo gjë deri tek ardhja e shoferit të autobuzit, tek porosia në lokalitë e Piskupatit, tek persona që kishin aktivitete të tjera, tek koha që do të ishte apo jo e mirë atë ditë, tek pjesëmarrja si tek ata që vinin nga Mokra, ashtu dhe nga ata që vinin nga Tirana, e shumë probleme të tjera. Për një kohë rreth 50 minuta tek pika e takimit u mbledhën mbi 30 vetë Istref Haxhillari, Zabit Çuku, Maliq Torra, Bujar Balliu, Mentor Balliu, Përparim Kalanxhi, Izja Dika, Ramadan Gjata, Bedri Mokrari, Xhevdet Diko, Arjan Isufi, Pëllumb Zade, Jorgji Buzo, Sali Torra, Seit Kalanxhi, Gani Pançi, Vasillaq Buzo nga Pevelani, Xhevair Shtupa, Eqerem Pllaha (K.Shokatës Gora per degën e Pogradecit, Flori Slatina, Sami Leka, Flamur Gjevori nga Elbasani, Selim Leka, Agim Fero, Nesti Maçolli, Tomi Mato, Përparim Isufi, Petrit Leka, Koço Pihoni, Vangjushi, Mondi Meçe (Inxhinieri nga Moglica dhendër në Mokër), Barjam Balliu, sponsori me zemër të madhe, Marjeta Balliu (këngëtarja e njohur e Pogradecit), Ismail Xhaja (bisnesmen nga Dunica sponsori i takimit), bisnesmeni i luleve mokrari

nga Slabinja, Agim Ferit Fero me një dhuratë lulesh të freskta, për aktivitetin festiv.

Ora 12.00 përhëndet takimin dhe pjesëmarrësit nënkryetari i shoqatës "Pelioni" Istref Haxhillari, një nga organizatorët dhe më dashamirësit e takimit. Urimi fillon me gëzuar dhe urime e takime te tilla paçim sa me shume me mokrarët e dashur të gazetës "Mokra, Dollia e parë ishte për mokrarët dhe sa më shumë vite festa e gazetës Mokër, për miqtë e shumë doli të tjera. Uron dhe jep mesazhet e urimet që janë dërguar takimit nga dashmires të azettes, nënkryetari i shoqatës "Pelioni" Zabit Cuku. Në pa mundësi për pjesëmarrje urojnë nga Tirana, Haki Balliu, Zenun Fero, Dylber Mani, nga Elbasani Hamdi Krasta Bashkim Krashta, Nevruz Balliu, Lida nga Elbasani, dashamirës nga Durrësi, nga Tirana, Laçi, Librazhdi, Çermenika, Rrajca, Rodokali, Përrenjasi e tjerë. Jep urimet e derguara, Preng Reci dhe Fadil Coba nga Puka e Mirdita të cilet jane lexues dhe dashmires të Gazetës dhe të Mokrës duke uruar jetëgjatësi paçi në shumë vite.

Për mua dhe për të gjithë ne "Partia" e jonë është Mokra, zëri i saj jemi ne, që jemi këtu, e kudo ku ka mokrarë.

Pëshëndet Ramadan Gjata ish-mësues dhe bashkëpunëtor i veçantë i gazetës nga Homezhi, Flori Slatina, kryeredaktori i gazetës "Mokra", Tomi Mato, Pëllumb Zade, kryetari i shoqatës "Pelioni, mjeku Petrit Leka, Maliq Torra, Koço Pihoni, një fjalim i këndshëm për mjeshtërinë e kulacit dhe hellin, Eqerem Pllaha (K.Shokatës Gora per degën e Pogradecit, per lidhjet bashkëpunimin midis shoqatave) Gani Premçi etj.

Dollitë e traditës u realizuan nga Istrefi e Maliq Torra. Kengetarët Istrefi, Nesti, Maliqi, Marjeta, Pëllumbi, Zabit, e tjerë.

Urimet vazhduan për gjithë pjesëmarrësit dhe për kolegët që nuk kishin mundësi për të marrë pjesë. Urime dhe festime e tëkime dhe në vende të tjera të trevës së Mokrës.

## NJËMËDHJETË VJET MË PARË...

(vijon nga faqja 1)

Me sytë e mendjes bredh nëpër kohën e thirrur, kujton varret e të parëve diku në një lëndinë përmbi fshat, fëmijërinë e largët që nuk kthehet më kurrë, të afërmit dhe miqtë. Njeriu i vërtetë me këtë boshllëk në shpirt ndjen nevojën të bëjë diçka për vendin e tij, sado e vogël, po që i lehtëson atij brengën e gjatë, të thellë sa deti. Nismëtarët, mbushur me kujtimin e vendit të lindjes, vendosën të nxjerrin këtë gazetë. Ata nuk e shkuan nëpër mend atëhere se e cini kështu në një tragë të vjetër të shqiptarëve, emigruar nëpër botë përgjatë një shekulli e ca më parë. Ishte e njëjta thirrje e gjakut të arbërit për vendlindjen si dikur.

Kështu nisi rrugën gazeta e thjeshtë, pa shumë pretendime, po me emrin e rëndë "Mokra". Flori Slatina, Haki Balliu, Llazi Tona, Fahri Muço, Zabit Çuku, Zenun Fero etj e nisën rrugën e gazetës pa qenë gazetarë, thjesht deshën të lehtësonin shpirtin e tyre llagar nga brenga e largimit prej vendlindjes së dashur. Pas punës së lodhshme të ditës, pas problemeve jo të vogla të jetesës në Tiranë, qëntonin atë pjesëzën e kohës së lumtur të shkruanin për bukuritë e vendit të tyre, për historinë e largët e të afërt, për këngët dhe veshjet e burrave e grave, për politikën e ditës dhe nevojat e zhvillimit të Mokrës. Shumë shpejt u bënë gazetarë të mirë, shkruan artikuj dhe reportazhe cilësorë, që i dhanë gazetës peshë e dinjitet, e rreshtuan atë përkrah simotrave më të pëlqyera. Përreth saj u grumbulluan të tjerë dashamirës të letrave dhe shkrimit, mokrarë në gen dhe bij të adaptuar që Mokra i ushqeu me bukuritë natyrore, shpirtin dhe mikpritjen proverbiale.

Pas ca kohe zunë të shkruajnë libra. Libra të vërtetë me shumë faqe dhe shumë vlera. Shumëkush i pa me mosbesim përpjekjet e mokrarëve për të shkruar libra. E ku ka patur ndonjë mokrar të bëjë tregime e romane, të shkruajë poezi apo të bëjë sfarëdo lloj letërsie? Jo nuk ishte parë. E shumta kanë shkruar letra,

kanë rrefyër ngjarje të thjeshta me pak fjalë, jo të bëjnë libra me shumë faqe.

Po ata nuk u tërhoqën.

I pari, Haki Balliu, me pamje dijetari dhe atë shprehjen e butë të portretit elegant, gërmoi historinë e lashtë të dheut mokrar, nxorri nga thellësia e kohës Dasaretët dhe kryeqendrën e tyre Pelionin e famshëm, ndër qytetet më të mëdha ilire. "Birkena e Pelionit" dhe "Rënia e Pelionit" janë dy vepra monumentale që do t'u tregojnë pasardhësve lavdinë e vendit të tyre, jehonën e një kohe që nuk do të harrohet kurrë.

Flori Slatina sprovon veten në poezi, ku hedh impresionet e moshës së re për dashurinë, natyrën, marrëdhëniet njerëzore, hovet e rinisë. Më pas ai nuk pushon kurrë së shkruari artikuj, përkthime, redaktime etj. Llazi Tona pas librit voluminoz për transportin rrugor dhe artikujve të shumtë për kishat dhe shenjtorët ka në përfundim memuarin për Shën Marenën, vepër unikalë në llojin e saj për shenjtorin e Mokrës. Zenun Fero, me trastën e librave e dokumentave në sup, gërmon nëpër arkiva dhe kujtesën e njerëzve, zbulon pareshtur fakte dhe dokumenta, pastaj shkruan librin dinjitoz "Slabinja jonë", një obelisk i përkryer për fshatin e lindjes. Shembullin e tyre do ta ndiqnin me entuziazëm të tjerë mokrarë, që rreken të ngjiten në vragën e spërdredhur të letrave.

Nesti Maçolli në Pogradec boton vëllimin me poezi të goditura. Maliq Torra në Velçan hahet me dheun tërë ditën, djersin e gulçon, po në mbrëmje hedh në letër vargje të mrekullueshme dhe boton njëri pas tjetrit dy vëllime me poezi. Poezi që mbajnë erë trëndëlinë e manushaqe, lagur me vesën e mëngezit.

Bujar Balliu për një vit rrjesht studjon jetën dhe veprën e nobelistëve të letërsisë përgjatë një shekulli e ca dhe në muajt e parë të këtij viti boton vëllimin prej 300 faqesh të titulluar "NOBEL". Kështu përreth "Mokres" sonë po grumbullohen gjithnjë e më shumë pena, deri dje në heshtje, po ngacmohen gjithnjë e më shumë burra e gra që e duan vendin e tyre, që i ze malli për ato troje të lashta dhe hedhin në letër me dashuri zemre ndjenja të holla e të vërteta njerëzore.

Gazetarë të "Mokrës" u bënë shumë dhe sot nuk mund t'i numërosh të gjithë. Pëllumb Zade, Dhimitër Gegprifti, Mine Fero, Sami Leka, Koço Pihoni, Xhevahir Shtupa, Ramadan Gjata, Agim Gorica apo dashnorët e zjarrtë të Mokrës sonë, Tomi Mato i rëndë si shkëmb, Spase Thanasi me ndjenja të holla, Meri Lalaj, Kristaq Nanushi e shumë të tjerë.

Është e pamundur të derdhësh në një flalë si kjo e sotnjë përjetimet e gazetës sonë, po nuk mund të rrija pa zbratur një pjesëz të impresioneve të mija në këtë përvjetor. Si pjesëtar i stafit të gazetës përhëndes me ngohësi të gjithë ata që ushqajnë me shkrime nga më të ndryshmet "Mokrën" tonë, këtë perëndeshë që sot mbushi njëmbëdhjetë vjet.

Ju uroj të gjithëve shëndet, gëzim e lumturi në familjet tuaja.

Gëzuar festën!

Istref HAXHILLARI

## Nekrologji/ Shoku ynë Agron !

Në datën 30.01.2010 mësuam me dhimbje, ndarjen nga jeta të shokut tonë të punës, bashkëshortit e prindit të dashur, qytetarit shembëllor, shoku ynë Agron Elmasllari! Ai u nda nga jeta, si një njeri i përkushtuar pas punës, në më se katër dekada në detyra të rëndësishme në administratën lokale, ku gjithmonë ka qenë model, si duhet të jetë një nëpunës i shtetit, korrekt i përkushtuar në kryerjen e detyrës, gjithmonë i sjellshëm i edukuar e shumë i njerëzishëm. Dhe si për ironi, fati i juaj, kish qenë e thënë, që ju të preheni, para kohe në përjetësi. Është e vërtetë se jeta një ditë ndarje ka nga kjo botë, por dhe ikja nga kjo jetë duhet të bëhet me një "Njoftim qoftë dhe verbal" Përse? Që njeriu i mire i shkreti njeri të ketë mundësi të ndahet qoftë dhe me disa ditë vuajtje e dhimbje e fizike, nga shokët, miqtë e gjithë të dashurit e tij! Kjo gjë nuk ndodhi për fat të keq me ju, shoku ynë Agron. Ndarja nga kjo jetë, nuk ju dha mundësi, që ju t'i mbyllnit të gjitha punët, ashtu si vepronit ju, ashtu si ata "Bilancet Ekonomikë" ku ju nuk harronit asgjë pa pasqyruar, duke qenë rregullsisht dukuri që juve ju karakterizonte, vlera këto, që ju i kini dëshmuar e kini lënë gjurmë tek të gjithë ata që ju patën njohur e punuan me ju, për të cilët, ju do jeni për ne e të gjithë ata që ju kanë njohur, për shumë kohë i gjallë e midis nesh Lamtumirë shoku ynë Agron!



NGA KOLEKTIVI I PUNËS NË BASHKINË E QYTETIT POGRADEC





## Në Velcan, atje ku denoncohet çdo ditë trishtimi

Ishin muskujt e shpirtit që më sh tynë të shkruaj për një udhëtim në vendlindje atje ku kam kaluar 35 vjet jetë e ku kam vëllanë, motrën, kushurinjtë e fisin që ditën e gëdhinë por nuk dinë se si natën ta bitisin. Malli për vëndin, për njerzit, për ato male ku u rrita më bën që të nisem me dëshirë për në Velcan e kjo ndjehet sapo mbërrin në Përrenjas e vëren lart në ato malet e Mokrës së madhe që si një lidhje shpirtërore të sjellin një mesazh ëngjëllor duke të thënë hajde biro në Mokrën tënde. Por gjërat që aty ndryshojnë duke të nxjerrë nga mendimet e bukura dhe duke të përballur me një realitet të trishtë pasi rruga për në Velcan ishte shumë e vështirë për t'u përshkuar nga veturat e për këtë u detyrova ta lë makinën time në Përrenjas e të nisem me furgon udhëtimi vazhdoi pak me merakun e makinës aty ku e lashë por harmonia, njerëzit e mirë, bashkshatarët e shokët mi si Maliq Torra, Serjan Elezi, Celik Elezi, Riza Torra e disa të tjerë bënë që të harroja e të futesha në botën e tyre të një Mokrari krenar, tradicional e harmonik pavarësisht ambjentit të mirë ku ishim ishte një gjë që na shqetësonte vazhdimisht, tronditjet e furgonit që nuk pushuan për një sekondë që po më dukej vetja në një garë me makina rrally por që më pas u bë rrealitë pasi furgoni ngeli e u desh që të gjithë të ndihmonim për të kaluar atë pjesë rrugë por avazi vazhdonte ec e zbrit, shty, hip e nisur përsëri tamam si në gara rrally ku në një moment thashë me vete ku po shkoj këshu vallë? Në Velcan apo në Afganistan. E do thoni ju për vendlindjen që e dashke aq shumë e krahason me Afganistanin, po po njerëz të mirë është pak të themi Afganistan pasi udhëtimi për në Velcan e nëpër të gjithë Mokrën është një torturë e vërtet me foristrada e jo më me vetura që është e pa mundur. Një rrugë e shkatëruar totalisht në disa vënde e shëmbur, shkurt jashtë çdo kushti dhe standarti inxhinjerik. Në Mokër miq e shok të mi për mua nuk funksionon as qeverisja vendore e as ajo qendrore nuk po i them këto për politikë por po i them pasi më dhimbset vëndi i lindjes më shumë se ata që vijnë në Mokër vetëm për të kërkuar VOTEN, për të dhënë premtime boshe e me pas largohen duke shijuar postin e ngrohtë që ju jep vota juaj, o mokrarë! Marr shkas nga një intervistë e deputetit Z Fatbardh Kadilli në janar ku shprehet se mokrarve ju kam borxh besimin pasi më besuan votën por jo vetëm nga ai por dhe për të tjerë deputet që kanë kaluar e shfrytëzuar mandatet e dhëna nga ju vetëm për qëllimet e tyre e jo në shërbim të popullit. Ju o popull nuk vutë mënd se nuk po ju kerkoni atyre mbrekullinë por gjënë më elementare dhe bazë, një rrugë që do të bënte më të lehtë komunikimin me pjesën tjetër të shqiperisë për të kuptuar se maxhoranca politike që perfaqëson Zoti deputet, objektiv të vetmin madhor të saj ka ndërtimin e Shqiperisë Europjane dhe ju vetë jeni shprehur zoti deputet se nuk hymë ne Europë pa bërë më parë që jeta e çdo shqiptari të jetë si e një Europjani. Jam plotësisht dakort me ju por a thua vallë Mokra është e plotësuar për çdo gjë për të qenë gati e në Europë, për mua jo jo pasi pashë një realitet të hidhur në Velcan. Një fshat që vuan për bukën e gojës. Pashë një dyqan që lista i kishte arritur 45 milion

lekë borxhe, pashë një fshat që rrëshqet nga faktorë natyror e që shteti nuk i gjendet pranë, pashë njerëz të pa shpresë tek fuqia e tyre e me sytë nga zoti e ndihma nga shteti. Jo jo nuk i përkasim dhe nuk do i përkasim një vendi europian dhe që adorojmë për në BE deri sa ne të kemi të zgjedhur që nuk zbatojnë parimet bazë të qeverisjes vendore e cila për mua nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë.

**Me Autonomi vendore unë di te drejtën dhe aftësinë efektive te bashkësisë lokale për të rregulluar e për të drejtuar brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë që ato përfshijnë në juridiksionin e tyre, një pjesë të mirë të çështjeve publike.** Nuk kuptoj se ku gjërat nuk shkojnë në pushtet qendror apo vendor por di këtë që banuesit në Mokër nuk po marrin një shërbim në të mirë të tyre dhe në të mirë të zhvillimit të zonës, pasi në 20 vjet vetëm janë gënjyer dhe nëpërkëmbur e vazhdojnë të nëpërkëmben për ndërtimin e një rrugë nga njerëz që kanë punuar vetëm për interes të tyre dhe asnjëherë në interes të komunitetit të Mokrës, të mokrarrëve. Shpresoj që Rruga Qukës-Qafë Pllaçë të mos jetë premtim bosh, sa për fushatën politike, pasi sot pas 11 muaj që ka filluar punimi i saj nuk punohet më për këtë rrugë. Marr shkas nga një emision televiziv i bërë në emisionin "Opinion" të Blendi Fevziut me të ftuar ministrin Sokol Oll-dashi pas një pyetje të bërë për rrugën Qukës-Qafë Pllaçë dhe Qafë Thanë-Pogradec e anashkaloi e nuk e përmendi fare. Kjo do të thotë se këto rrugë nuk janë në plan të shpejtë të qeverisë Shqiptare. Mokrar, që megjithëse me vuajtje e me halle kanë përballuar vazhdojnë të përballojnë jetesën e tyre që sa vjen e nglet pas në krahasim me kohën që ecën e që Mokra nuk po e arrin dot, pasi duhet të kuptojmë se demokracia e vërtetë ka për bazë dëshirën dhe vullnetin e popullit dhe jo atë të pushtetarëve dhe se mbi të gjitha ajo është kundër tiranisë dhe formave të ndryshme të saj. Unë i bëj thirrje si pushtetit qendror dhe atij lokal se keni rastin më të mirë për kohën që jemi, për koalicionin që keni, të bëni diçka për Velcanin në veçanti dhe Mokrën në tërësi. Mendoni për të ardhmen e fëmijëve tuaj dhe brezave që vijnë që Mokra të mos braktiset. Ne populli i thjeshtë i Mokrës së madhe duhet të nxisim dhe të bëhemi krah i intelektualëve të cilët kanë dëshirë të punojnë për Mokrën duke patur shansin të lenë gjurmë në histori dhe emrat e tyre të permenden gjatë në brezat e ardhshëm, duke ju vënë një kusht, atë të ndërtimit të rrugës, por para votimeve e t'ju mbyllim gojën atyre të cilët kujtohen për Mokrën vetëm kur ka zgjedhje e duke ju mbushur mendjen juve se ky është ai që mund të bëjë atë, rrugën që të gjithë mezi e presim. U bëj thirrje intelektualëve, biznesmenëve, fermerëve, njerëzve të thjeshtë etj të Mokrës të cilët duhet të ngrënë zërin dhe të bashkohen për një detyrim të përbashkët për vendlindjen. Për të mos i dhënë mundësinë brezave të ardhshëm të na fajësojnë për pasivitetin tonë si pjesëtarë të Mokrës.

**Me respekt: Lytfti MENKSHI**

## TOKAT E LËNA PA MBJELLË, DO TË JEPEN ME QIRA NJË FERMERI TJETËR

Nga Astrit ELEZI

Qeveria konkretizon nismën për lëshimin me qira ndaj të tretëve të tokave që nuk kultivohen nga pronarët. Projektligji i cili synon të stimulojë shfrytëzimin e tokës. Ky projekt do të kalojë në mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese dhe në Kuvend. Projektligji synon të ndalojë fenomenin e lënien e tokës djerr për shkak të ndryshme prej pronarëve duke i dhënë të drejtën përfaqësuesëve të qeverisjes vendore që ta lëshojë atë me qira ndaj personave të tjerë që kanë shprehur interesin për të shfrytëzuar më shumë sipërfaqe tokë. Ai ka të drejtën e shfrytëzimit të tokës me kushtin që të mbjellë bimë arash dhe jo dru frutorë.

Për verifikimin e tokave të lëna djerr fillimisht ngrihet një Komision i posaçëm i përbërë nga, Kryeplaku i fshatit dhe përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe zyrës së menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës. Komisioni bën çdo vit, brenda 15 shtatorit, verifikimin e sipërfaqeve të tokave të pa kultivuara për çdo apo komunë. Verifikimi bëhet duke u bazuar në këqyrjen fizike të sipërfaqes tokës, në të dhënat kadastrale dhe informacionin e siguruar nga vërtëtori i saj. Nëse pronari mungon komisioni mund të sigurojë informacion edhe prej fermerëve të tjerë që kufizohen me të apo nga të afërmit. Pas verifikimit, rezultatet për çdo parcelë, pasyrohen në një dokument të posaçëm. E gjithë kjo procedurë duhet të përfundojë brend datës 30 shtator të çdo viti. Të gjitha të dhënat e mbledhura i kalojnë kryetarit të njësive të qeverisjes vendore. Pas marrjes së të dhënave nga verifikimi në terren i parcelave, Brenda datës 15 tetor kryetari i

Komunës apo Bashkisë afishon në një vend të dukshëm për një periudhë 45 ditore listën e pronarëve të tokave që janë gjetur të pa kultivuara. Më pas lista me parcelat e pa shfrytëzuara dhe emrat e pronarëve shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit të njësive të qeverisjes vendore i cili merr vendimin për shpalljen e tyre si toka të pakultivuara që do të lëshohen me qira ndaj të tretëve. Pas këtij vendimi, toka mund t'i jepet me qira një fermeri tjetër që ka shprehur interesin për më shumë tokë në shfrytëzim. Edhe në këtë rast ligji i njeh te drejtën pronarit të ligjshëm të saj ta rimarrë atë në përdorim me kushtin që ta fillojë kultivimin e saj. Në këtë rast, pronari i tokës i paraqet kreut të qeverisjes vendore një plan për shfrytëzimin e tokës, përfshirë kulturën bujqësore, sipërfaqen dhe afatet e kultivimit. Në këtë rast, toka nxirret nga lista e parcelave të pa kultivuara dhe i jepet pronarit. Nëse përsëri vërehen se ai nuk ka filluar kultivimin e tokës ajo futet automatikisht në listën e tokave të pa shfrytëzuara dhe u afrohet të tretëve me qira. Nëse fermerët nuk e rifillojnë aktivitetin e tyre per punimin e tokës edhe pas përfundimit të kontratës, ajo u jepet sërish me qira palëve të interesuara. U jepet njësive vendore, komunave edhe disa bashkive që kanë edhe fshatra në njësini e tyre administrative që të operojnë me këto sipërfaqe të pakultivuara për t'i marrë dhe për t'i dhënë me qiradhënie. Fermerët përsëri ftohen dhe ka një afat për të cilinata mund të rifillojnë të kultivojnë tokën. Nëse nuk e rifillojnë aktivitetin, ajo do t'iu merret dhe do të jepet me qira. Në përfundimin e kësaj kontrate dy-tre apo edhe psevjeçare, ai mund të reflektojë, mund të jetë kthyer nga emigracioni dhe të jetë i gatshëm ta rivërë tokën në qarkullim ekonomik.



**Redaksia e gazetës "Mokra" si dhe kryesia e shoqatës "Pelioni" urojnë kolegun e tyre Zenun Fero për martesën e të birit, Blerimit. Të trashëgohet e me jetë të lumtur!**

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"

Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës

Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

[www.pordeci.com/mokra](http://www.pordeci.com/mokra)



Këtë vit, Islam Berberi shkeli 90 vjeç. Është një burrë punëtor, musalli, nikoqir e me nder në ballë. Megjithëse, siç thashë, i thuri 9 dekada në lëmin e jetës, ai punon, ecën nëpër qytet pa bastun, me një trup qiri, e që nuk ankohet kurrë nga ndonjë sëmundje. Sa herë që e takoj e pyes:

- Si je, o miku im i hershëm?  
E ai gjithmonë e ka përgjigjen në majë të gjuhës.  
- Kur ke një grua që të përgjehet, siç kam unë Baren, e ke shëndetin top frëngu!  
Dhe i qesh jo vetëm fytyra, por edhe sytë. Rrallë gjen në Pogradec një njeri që të jetojë në pleqërinë e rëndë e që të punojë njëkohësisht. Gjithë jetën e tij ka qenë bahçevan e në kohën e lirë është marrë me "kazanin e rakisë". Edhe tani i kthen kominat (bërsitë) e rrushit, kumbullës së egër apo gjatës dhe dardhës, në raki. Si atë që nxirret i ndjeri Mitrushkë. Këto ditë e gjeta Samën duke nxjerrë kominat dhe duke mësuar birin e tij. Ai ngul këmbë që kjo është një traditë që duhet ta trashëgojë edhe Catja. Pikërisht aty, kur po pikonte pika e parë e kazanit e dafti qelbar, që ta trullos mendjen, i vajta pranë. Ai u ngrit, ma mbushi gotën e më tha:  
- Të lumshin këmbët! Ma bëre qejfin pushkë që më vizitove. Të paça me nder!  
Në fjalë e në muhabet, guxova dhe e pyeta:  
- A ka mundësi të të bëjë një pyetje? Ai kërcuua përpyetë duke më thënë:  
- Dy të më bësh! Po pres...  
Shtruar dhe ëmbël i kërkova:  
- Juve Berberët keni qenë familje e ngrehur në qytet. A s'më thua, duke qenë se femija mban mend shumë, nëse kë ndonjë kujtim nga fëmijëria apo nga rinia jote që e kujton me kënaqësi edhe tani në pleqëri?

- Kam shumë - m'u përgjigji ai - por njëherë në veçanti do ta mbaj me vete deri në varr e do t'ia tregoj bekrinjtë në botën tjetër.  
Në këtë mënyrë u bëra kurioz dhe duke i uruar pleqëri të mbarë e pasi të shkelë një shekull iu luta të ma tregonte. E ai m'u përgjigji se do ta bënte këtë gjë me gjithë qejf.  
- Vetëm duhet ta dish se ti je i pari që po e dëgjon këtë histori. Babai im Serjati shkoi në një gosti në Mokër. Më kujtohet që ka qenë vjesh-ta e vitit 1930. Ai jo vetëm që i njihte mokraret, por edhe i donte ata dhe gjithmonë ka luftuar që ta forconte miqësinë me ta. Një ditë i tha të vëllait, Myslymit: "Vëlla, unë kam vendosur të gjë një nuse në Mokër. Mos ma prish qejfin. Nëna dorën." Myslymi ja dha e i tha: "Le ta shohim më parë, e më pas të pimë kafetë". Ndërkohë që babai ju përgjigji - Nusën e kam parë, s'ka nevojë ta shikosh ti. Me të çmallu kur ta shikosh në jatak". Myslymi e mbylli gojën.  
Të nesërmen shaloi mushkën e mori bre-gun përpyetë. Vajti në Kalivaç në shtëpinë e Rushan Jaupit. Sa e pa Rushani i tha:  
- Bujrum e mir se erdeh e mik i dashur". U përqaftuan. Hynë në dhomën e miqve, në vatrë, zjarri filloi të kërcasë nga drutë e dushkut. E mori fjalën babai:

"- E dini pse të kam ardhur sonte në konak o miku i zemrës?" Rushani i tha:  
"- Për tu fjalosur". Babai ia previ:  
"- Për tu fjalosur e për ta forcuar miqësinë. Dua të më japësh çupën tënde për tim vëllai, Myslymin, mos ma prish. Rushanit i ra si bombë mbi kokë kjo kërkesë. S'u mendua gjatë, nuk pyeti as të shoqen. Zgjati dorën, përpoqi gotën e rakisë e si burrë zamani i tha:  
"- Të na trashëgohe dhe e paçin një zhgan fëmijë rreth vatrës. U martuan, u trashëguan."  
Gjatë kallximit qëndrova indiferent, s'kuptova diçka të jashtëzakonshme. E kuptoi shqetësimin tim Sama. Si pa vetëdije i ndërhyra:  
"- Kjo ishte siç thuhet hyrja, tani fillon çudia. Dëgjomë me vëmendje:  
Rushan Jaupit i dhuroi Allahu, veç vajzës edhe katër djem. Dy ja mori Zoti. Kur i treti e dëgjovi 20 vjet qyzen të kërkojë kukun, në lajthitë e malit Qozicë, e thirri të birin, Xhev-itin. Në prani të së shoqes i tha:  
"- Skopaku i bubit, ka vite që të mbivi qimja në faqe. Nënës siç e di i kanë rënë halle mbi halle, s'i përballon nevojat familjare. Kana nevojë për ta ndihmuar nusja jote. Bjeri anembanë Mokrës, vërja synë një çupe. Babai ka borxh të vejtë ta kërkojë. Ngrije kokën dhe ma jep fjalën."  
Ndërhyri e ëma:  
"- Kush nuk u martua e nuk u gëzua, gëzoju dhe ti, gëzoje dhe babanë e nënën tënde."

## Dasmë mokrare me saze

Nga Tomi MATO

Xhaviti ishte skuqur nga turpi dhe kishte nxjerrë ankthin që i rëndonte në zemër:  
"- Baba dhe ti nënë, nuk është nevoja të kërkoj nuse në Mokër, çupa të mira dhe të bukura ka dhe në fshat. Kur e pashë njëherë duke mbushur ujë në krua, mu hodh zemra sikur deshte të dilte nga gjoksi."  
Prindërit u gëzuan:  
"- Kush është ajo çupë që të paska mbushur synë o evlat?"  
"- Fetija, e bija e Hamzajt të Kalivaçit."  
U fejua Xheviti, u pre dita e dasmës. Krushku Rushan dërgoi mushtullukët dhe na ftoi në dasëm. Gjysh Koçiu mbledhi tre djemtë Myslymin, Nevruzin dhe babanë, Serjatin. Ju dha myzdenë, i pyeti:  
"- me çfarë peshqeshi do ta nderojmë krushkun? Hapni gojën."  
Myslymi tha:  
"- t'i çojmë një dash që t'i ketë brirët tre herë të dredhur..."  
Nevruzi tha:  
"- T'i bëjmë një revani me gjalpë dhie dhe një bukë me qiqra."  
Serjati shtoi:  
"- Këto do t'ia shpiem krushkut Rushan, por unë mendoj t'i shpiem diçka që nuk e ka shpënë njeri nëpër dasmat Mokrare." Gjyshi bashkë me djemtë e pyetën:  
"- Pa na thuaj me çfarë?"  
"- Me saze. Mokraret janë bekrinjtë, nëpër dasma këndojnë dhe hedhin valle. Ne po t'i çojmë saze, do ndizen jo vetëm konakët e fshatit por edhe të fshatarëve që do dëgjojnë të ulurijne sazet." Ndërhyri dhe njëherë Myslymi:  
"- Kjo që na thua ti o vëlla është hata, po ku ti gjejmë sazet? Deri më sot kam qenë në shumë dasma, në kaurët e qytetit, asgjekund s'kam parë saze. Këtë muhabeti vëri përsipër gurin e mullirit të Liçit."  
Babai i ra gjoksit me grushte aq fort sa kujtova që ju bë vrimë. U zotua:  
"- Do vete në një mikun tim në Korçë. Jam i bindur që do më gjejë një palë saze."  
I dhanë leje dhe kur e takoi mikun ai i tha:  
"- Do ta nderosh krushkun Rushan Jaupin e Kalivaçit? Pajtoji këta sazezë: Rushankën me gërnetë, Demkën me qemane, Cilon me bakllama dhe Qerimenë me dajre. Kur i kërcen gishtërinjtë mbi dajre dhe dreth zërin Qerimeja, tunden themelet e shtëpisë."  
I solli sazet babai, përgatitëm karvanin. Kuajve u vumë fjonogo të kuqe te veshët, kinde të kuqe mbi samarë, dashit mollë të kuqe në brirët dhe morëm rrugën përpyetë. Unë isha i vogël, 11 vjeç. Vendosa të shkoj më këmbë.  
Kur karvani i dasmorëve kaptoi mbi breg, përpara syve u shfaq si në perde të filmi, panorama e Mokrës. Rushanka, e magjepsur nga kjo bukuri përallorë i tha babait:  
"- O Serjat, pa më trego sesi quhen këto male e pyje kaq të bukura? Babai zbriti nga kali dhe e njohu me bukurinë e natyrës mokrare.  
"- Ato male, që ngrihen sikur duan t'i japin dorën Allahut dhe zbrisin sikur janë zënë dorë për dore e hedhin devollin, quhen "Kurora e Valomares". Ai gëmiri i madh që shikoni në cepin e Valomares është Gur Topi (e ka marrë këtë emër kur francezërtë në luftën eparë botërore luftonin me nencin, i shpunë topat në majë të shkëmbit. Aja maja që ngre kokën e kërkon të dalë mbi Gur Top, quhet Gurri Nikës. Atje e kanë folenë derrat e egër.  
Ndërkaq, ndërhyri Demka:  
"- E më ja hënksa mblodhën buzët. Më pas e mori fjalën Qerimeja:  
"- O Serjat aga, po ky mali që na rri mbi kokë e që duket sikur është pampor si e ka emrin?  
"- Ky mal, moj thëllëza plakë e sazeve të Korçës e ka emrin Kozicë, që ship do të thotë dhi. Atje lart ka jo vetëm zaire për dhite, caporet e njohura ngjyrë kafë të Kalivaçit, por edhe shumë vakëfe si kisha e Shën Spasit e ajo e Shën Premtes. Por, Mokra o sazezërinjtë të Korçës (veç legjendave e gojëdhënave të kohës së Pelionit), ka edhe këto male nga të cilat Skënderbeu nisi kavalerinë mokrare dhe bënte

somatë turkoshakët në fushën e Demosdovës.  
Rushanka nxori gërmetën dhe i mori leje babait:  
"- A ta përshëndes Mokrën me një kaba, o Serjat aga? Kjo bukuri e ky popull duhet përshëndetur. Por babai i ndali.  
"- Mokrën dhe mikun e zemrës do ti përshëndesësh kur të të vemi mbi kroin e fashtit.  
Karvani vazhdoi rrugën, disa mbi kuaj e disa më këmbë. Dalëngadalë kur dielli po fshihej mbrapa maleve të Valomares arritëm te kroin mbi fshat. Babi zbriti i pari dhe dha urdhër që të hanim një kafshore bukë, që mos na zinte raki. Kështu, nëna nxori një kulaç e preu dhe vuri nga një copë djathë nga mëshqerra. Sapo filluan të hamë babai uroi:  
"- T'u trashëgoftë djali, o krushku Rushan! Si e puthëm të gjithë grykën e plloskës, sazezërinjtë tiraklinjtë pas rakisë erdhën në qejf. Babai i gëzuar ju drejtua kapos së sazeve:  
"- Merrja një kaba ta marrë vesh fshati që erdhi krushku me sazet e Korçës. Rushanka ja bëri nderin babait.  
"- Kë avaz të marr o Serja aga?  
"- Kë të të dojë xhani ty! Pasi sazezërinjtë u bënë gati, Rushanka dha urdhër:  
"- Në bahçen tënde mbolla një qershi, do ja çoj bandillit meze për raki"  
Ushtroi zëri i ëmbël i Qerimesë. Gjithë fshati doli nëpër dritare, ballkone e oborre. Nuk kishin dëgjuar më parë muzikë. Një plakë kur dëgjoj muzikën e zërin e Qerimesë, ju tha më zë të lartë fshatarëve"  
"- Hyni brenda se këndojnë e lozin xhindet! Ashtu, duke ju rënë veglave e duke kënduar hymë në shtëpinë e krushkut. Ai i lemeritur nga kjo çudi ngriti zërin:  
"- T'a paça borxhe nderin që më bëre o Serjat! Filloi kënga mokrare që këndohet nëpër dasma:  
Mori zoti i dasmës  
Një, mre, një  
Na rreë sa raki ke  
Një, mre, një  
Ta bëjmë dasmën pa gajle  
Një, mre, një  
  
Mori zoti i dasmës  
Një, mre, një  
Na rreë sa raki ke  
Një, mre, një  
Ta bëjmë dasmën pa gajle  
Një, mre, një  
Krushku Rushan u kënaq kaq shumë saqë duke përqaftuar babanë i tha"  
"- Zjarr i vure shtëpisë o krushk. Ndërkohë që për ta nderuar bashkëfshatarin e tyre, i gjithë fshati kishte përparuar nga një konak. Babanë e vuri krushku në krye të këndit. Ai i ngazëllyer i tha:  
"- Ti je i parti në dasmën e djalit. Babai mori gotën dhe uroi:  
"- Djali të trashëgohet e dhëntë Allahu t'i japë një zhgan me djem!  
Jo vetëm në oborin e krushkut, por edhe në shumë shtëpi të tjera valonin zjarret, piqeshin deshinjët. Oborri i shtëpisë kishte plot bagëti që ja kishin sjellë Rushanit për ta nderuar. Sazet valonin, dasmorët pinin e këndonin. Dollitë vazhdonin njëra pas tjetres, mezet që nga dardhët, turshitë, salca e helli mbi tepsi i jepnin një hijeshi sofrës e gazit.  
Babai e ngacmoi Isuf benë:  
"- E pe krushku kishte anemandë shtëpisë nga një pjergull. Qëndisi ndonjë këngë.  
Isufi ju drejtua Qerimesë:  
"- Mbaja me dajre, moj esmerja e Korçës. Qerimeja e ngriti darjen, ndërsa Isufi filloi:  
Rushi i zi i dendurë  
Bën verën e ëmbëlë  
Pinë plakat dehenë,  
Dehen, rëkëllehenë  
E c'i shajnë nusëtë.  
Gjithë dasmorët mbanin hijet me duar nga të qeshurat. Isufi këndonte e kërcente, Qerimeja e ndiqte me dajre. Ai vazhdoi:  
Rrishi i zi i dendurë  
Bën verë të ëmbëlë  
Pinë nusët, dehenë  
Dehen, rëkëllehenë

E c'i shjane vjehrratë.  
Dasma mori flakë. Si u ngritën shëndetet e dollitë, afër mesantës babai i tha Isuf Beut:  
"- Ngrehu e na thirr Jacinë Isuf Be! Ja bëri qejfin. Hapi dritaren, vuri dorën e majtë te veshi si hoxhallarët e ngriti zërin!  
O All, il Alla  
Këtu paska thela të mëdha  
O All, il Alla  
Po nesër unë i varfri çfarë do ha?  
Në këtë atmosferë, në konakun e parë erdhi plakus Tosun e ju drejtua sazezërinjtë:  
"- Hajdeni e ju fryni këtyre fytyrë e zumave.  
U ngrit Rushanka duke i rënë gërmetës, i cili shkoi te konaku i Tosunit.  
Burra, gra, të rinj e pleq u ngritën në valle. I ndoqa pas sazet. Një nga pleqtë që nuk kishte dëgjuar më parë saze, mori gotën e i tha Rushankës:  
"- Ulma atë fyjllin, tua bëj bromn atyre xhindeve që ja thonë kaq bukur brenda në trumbetë. E uli gërmetën e ja hodhi gotën e rakisë duke e uruar:  
"- Ju lumtë goja e zemra, sa bukur ja merrni. Rroftshi e trashëgoftshi! Sazet që na solli krushku nga kasabaja, do na e shtojnë ymrin. Rroftë krushku!  
Gazi i veçantë shpërtheu kur në mes të lëmit e rojtën dhëndrin. Sazet ja morën kaq bukur sa u mbledh i gjithë fshati, e të gjithë të ngazëllyer hidhnin valle gorarçe. Kulmi i gëzimit ishte kur u nisën krushqit me dhëndrin në krye për të marrë nusën. Doli nusja me kokën e mbuluar me duvak. E hipën në kalë dhe e sollën në shtëpi. Në ballë të karvanit të krushqevanin sazet. Me të hyrë ku karvan me nusën në krye të shtëpisë xhaxha Nevruzi ja mori këngës bashkë me Qerimenë:  
Gëzoju, nëno gëzoju  
Se të erdhi një urdhëratë  
Nëno gëzoju  
Dy tri herë do t'i thuash  
Gjene vetë do të ngrihesh.  
  
Dasmorët shoqëronin këngën me valle. Qerimeja vazhdoi këngën:  
Gëzoju baba gëzoju  
Se të vjen një urdhëratë  
Baba gëzoju  
Dy tri herë do t'i thuash  
Gjene vetë do bësh kafënë.  
Krushku Rushan nuk e dinte këngën e mundahej t'ia mbannte izon. Ndërhyri Isuf Beu:  
"- Krushk, dasmë me saze në Mokër vetëm ti ke bërë. As tugararë e kasabasë nuk kanë bërë dasmë me saze. Ngjiti një kartmonedhë kësaj esmerkës që e çau dajren dhe e ngjiri zërin. Jo vetëm Rushani, por edhe dasmorët e tjerë ja mbuluan ballin me kartmonedha. Plakat thoshin:  
"- Kjo femër është kanxhalloskë.  
Isuf beu i vajti Qerimesë dhe i tha"  
"- Ule dajren se u bëre telef. Ja po të jap dhe unë një dhuratë. Ja vuri në dajre qesen me masat, eshkë e gur e i tha"  
"- Unë këtë kam, ta dhash por do ta marr prapë se nuk kam me se ta ndez çibukun.  
Qerimeja ju hodh në qafë, plakat kthenin kokat e pëckonin faqet ndërsa burrave ju mbajt fryma nga të qeshurat.  
Kulmi i gëzimit ishte kur mbyllën dhëndrin me nuse në odë. Isuf beu i tha Demkës:  
"- Merrja njëherë më atë qemane si ja merr bilbil gjyzari.  
E Demka ja morri shtruar:  
Ç'i mban syçkat përdhe,  
Faqe portokalle më jam,  
Frikë më ke, turp më ke,  
Faqe portokalle jam.  
As frikë kam, as turp s'kam,  
Faqe portokalle më jam,  
Lashë nënën që më qan,  
Faqe portokalle më jam,  
Lashë babanë që po më qan,  
Faqe portokalle më jam.  
Sazet mbas dasme qëndruan dy ditë në Kalivaç. Miqtë e Rushan Jaupit i ftonin për drekë e darkë. Kur i përrollën jua u mbushën torbat me mish e revani. Qytetaret, mbas dasmës që bëri Rushani me saze, filluan nga viti 1938 të ngrejne sazet e dasmave. Xhipi me gajde, Sabriu me klarinetë, Lika me dajre, Vasili i Lamit me daulle. Aman ta dish o miku im, për herë të parë në Mokër u bë dasëm me saze, kur u martua Xheviti, djali i krushkut Rushan Jaupit në Kalivaç.  
Përfundoi rrëfimin Sama te kazani i rakisë.





## Pija e perëndive

Taulant KARASALI

**Q**ë në lashtësi kjo pije ka pasur vlera të gjithanshme, shëruese e trupit dhe e shpirtit. Pija e magjishme ka bërë njerëzit për vete. E cilësuar si pije e perëndive dhe e mbretërve, sot e përdor çdokush, i vogël e i madh. Dy mijë e pesëqind vjet më parë tërë Ballkani ka qenë me vreshta pa fund. Njerëzit nuk e njihnin ujën për pije, jetonin një shekull e më shumë. Edhe fëmijëve kur kishin etje u jepnin verë. E sot në qytetin tonë përdoret kjo pije magjiplote pothuajse në çdo familje, gjatë gjithë periudhës dimërore, nga të krishterë e myslimanë, nga të rinj e të reja, nga të vegjël e të moshuar si pije që të ofron shëndet e jetëgjatësi. Shpeshherë dëgjojmë se cilësia e saj vjen nga vjetërsia e qëndrimin nëpër butet e drunjta. Shkrimtari ynë, Istref Haxhillari, i krahason cilësitë e saj me ato të vajzës. Ajo duhet t'i kalojë të njëzetat pa të martohet, kush e prek pa ardhur koha bije në mëkatën e përdhunimit. Kush kërkon jetëgjatësi duhet të përdorë me shije dashuri pijen e perëndive.

Portretizimi i personazheve është krejt i veçantë. Mënyra e paraqitjes së tyre në tregimin "Syri i dimrit", ku vera është kryepersonazhi, ngjan me rrjedhën e gurgullimën e verës kur këndon në bute e me këngën magjiplote që vetëm ajo di ta ngjallë. Doktorin, personazhi më mbresëlënës flet bukur, por është edhe më bindës kur hesht. Ai i kthen pacientit të tij shpresën e jetës kur ajo po venitej në trishtim. Infermiere Xhina u fal pacientëve ngrohtësi dhe u rri pranë në çastet më të vështira. Aroma e saj hynte dhunshëm në tërë qenien e të sëmurit, e dehte, e dalliste me dashuri e shpëtim. Të gjithë personazhet kanë dëshirë të rroken fort pas jetës, të marrin e falin ngrohtësi që çastet të çelin gonxhet e shpresës.



## Vite pa ngjyre

Argita DIKO

Nga moria e tregimeve të librit "Bari i ujkut" më ka bërë të mëndohem "Vite pa ngjyre". Pas leximit mu fanit mendimi "Njeriu nuk mund të jetë i lumtur pa qenë më parë fajtor".

Dhimitri ishte një i moshuar me të cilin vitet kishin bërë punën e vet. Lumturia e tij fillon te tretet pak nga pak dhe ai e ndien veten të tepërt dhe fajtor në familje. Në fakt një fajtor pa faj, sepse faji i tij i vetëm ishte pleqëria, ajo që është e ardhmja e kujtdo. Ata njerëz që shpërfillin moshën plaken më shpejt, afrohen në sinorin ku prehen të shumtë. Dhe në familjen e tij duket më së miri kjo mospërfillje ndaj më të moshuarve. Indiferentizmin më të theksuar e gjejme te nusja e djalit, Desada, e cila tregohet tepër inatçore dhe ka ndot nga i vjerri. Plaku gjithnjë e më rrallë ndiente ngrohtësinë e familjes, i dukej vetja i tepërt si mobilje e vjetëruar që zinte vend dhe pengonte të tjerët. Nuk ishte ai që e perzgjodhi vetminë, por ajo e kaploi atë tërësisht. Mirëpo në jetë ka edhe njerëz që i respektojnë dhe i duan të moshuarit dhe këte e hasim te familja e Limit, shokut të Dhimitrit. Nusja e djalit të tij nuk ia kthente



Autori, Istref Haxhillari, mes nxënësve dhe mësuesve të shkollës së mesme - Starovë

## NGA PROMOVIMI I LIBRIT "BARI I UJKUT" NE SHKOLLEN E MESME STAROVE

kurrë fjalën, e dëgjonte dhe e respektonte atë, kjo nuk ndodhte me Dhimitrin.

Nga jeta bosh dhe nga kujtimi i gruas se tij të ndjere, Tinkes, atij shpesh i rridhnin lotet. Nuk ka ngushëllim më të mirë se lotët kur ai lag e ngroh fatkeqësitë tona.

Për Dhimitrin tre ishin të keqat e kësaj bote, siç thoshte edhe ai: vdekja në të ri, fukarallëku në pleqëri dhe shërr në shtëpi. Ai vazhdoi të mendonte kështu deri në momentin kur zemra e tij ndali.

Keto fenomene i ndeshim shpesh në shoqërinë tonë, por pakkush merr guximin të flas artistikisht për to. Shkrimtari Istref Haxhillari e ka bërë këtë me art duke na vënë në mndime për këtë moshë pranë fundit që shpesh nga e bardhë që duhet të jetë ditët e mugëta e e errin."



zjështë tronditëse. Duke kaluar nga një shpirt i qete në tallayitje nervoze përcaktohet plotësisht zhvendosja metamorfike ...

Prozatori është në afinitet të plotë me gjuhën poetike, me figurat letrare, gjetjet të japin ndjesinë e së bukurës tronditëse, personazhet përjetojnë bashkë me mjedisin e natyrën.

Aforizmat, shprehje mençurie e konceptimi estetik, luajnë rol të rëndësishëm jo vetëm për ngushëllimin e personazheve, por edhe të lexuesve ...

"Duart kanë pushtet misterioz për të lehtësuar brengat e njerëzve" ...

Ato janë të shumta, të larmishme, interesante dhe shprehin një filozofi specifike të konceptimit të jetës nga autori.

Këto janë vetëm disa nga vecoritë e krijimtarisë së prozatorit pogradecar Istref Haxhillari. Të shfletosh veprën "Bari i ujkut" surprijohesh nga karakteristikat e veçanta të secilës prej prozave që për mua janë shumë poetike.....

## Muzgje të thinjura

Nerila VEIZLLARI

Tregimin "Muzgje të thinjura" të fut në një botë ku ndjen konceptimin e jetës sipas filozofisë popullore, por dhe jehonat e filozofisë panteiste. Ash-tu si Naim Frashëri i cili e shihte zotin të shkrirë në gjithçka edhe banorët e Volamarës kanë të njëjtin vizion për zotin (perëndinë). Duket se këto qenie jetojnë me filozofinë universale të Rilindjes së kombit. Imagjinaria dhe realja janë një. Nuk ka kufi ndarës për këto, gjithçka që ekziston ka jetë, është e perëndishme.

Shkrimtari i përshkruan personazhet me detaje mbresëlënëse. Por jo vetëm personazhet, edhe mjedisin, natyrën dhe gjithçka tjetër. Kjo të bën të mendosh në është legjendë, të dyshosh në konceptet e tua për jetën. Legjenda e dy të dashuruarve të kthyer në gurë me vështrim nga njëri-tjetri duke u përpjekur të përqafohen, por që nuk mundën, është përshkruar aq bukur nga shkrimtari të detyron të besosh se kjo është ngjarje e vërtetë e ata dy gurë ende kanë jetë.

Intelektualiteti i të shkruarit të ben për vete që në kontaktin e parë që me librin, aq sa nuk je në gjendje ta lëshosh librin nga dora pa e çuar në faqen e fundit.

Unë e kam lexuar dhe romanin "Pesha e kohës të ketij shkrimtari. Atje është pranë vendlindjes këtu mes problemeve universal e të gjithëkohshme. U këshilloj edhe juve t'i lexoni këta libra për ta ndier veten mes mrekullisë së artit.



## Disa mendime për tregimin "Samanta"

Borana KUQO

Së pari ndeshemi me një nga fenomenet që ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë dhe sot në shoqërinë tonë, atë të tradhëtisë bashkëshortore. Në qendër vihet dashuria: Nëse është me pasion që zgjat apo nga ato që shuhet, thjesht kalimtare. Që në fillim njihemi me dy personazhet kryesore të cilët arritën të përjetonin dashuri të madhe, por përfundoi në zhgënjim dhe me fund tragjik. Serdi, burrë me karakter të fortë, të padepërtueshem, në moshën 43 vjeç, jeton në Itali dhe është sipërmarrës i luleve natyrale, njeri me forcë e me peshë karakteri.. Samanda, grua e re, shumë e bukur, me sy të zinj e te medhenj si copa smeraldi, lekure te zeshket brune, leshra te gjata dhe te dendura me sjellje lozonjare. Samanda na pershkruhet me detaje shume te hollesishme per sa I perket fizikut te saj, shfaqet disi e cuditshme, nuk kemi te dhena qe te tregojne dashurine e saj per Serdin por vetem moment kenaqesie qe kalon çifti. Përballe kenaqesive qendron portreti I saj I embel dhe I bukur qe arrin te ndezi ndjenjat e cdo burri. Ndersa per Serdin ka me pak detaje ne pershkrimin fizik te tij por na mjaftojne ato te gjendjes shpirtore per te kuptuar se tek ai ekziston nje dashuri shume e madhe, e paster, qe kapte te perendishme plot lumturi, emocione qe mendonte se kurre nuk do te shuheshin. Jeta e tij kishte ngecur neper syte e prushte dhe leshrat e gjata te Samandes. Kur kjo dashuri ka qene kaq e paster ne zemen e ketij burri, perse përfundoi ne tradhete? Ndoshta ajo qe I ndodhi ishte pagesa e asaj qe ne te kaluaren kishte qene aventurier dhe tani ai merrte shperblimin qendronte mbi gishtat e nje gruaje. Duket sikur fati e ndoqi ate. Perse Samanda arriti ta tradhetonte njeriun qe ishte gati te bente cdo gje per te dhe te jepte jeten e tij? Pas kesaj pyetje kemi nje pergjigje: Ndoshta ajo cfare ka ndjere Samanda per Serdin ka qene thjesht nje pasion kalimtar qe rrok ndjenjat e cdo gruaje ne moshen e saj. Ne kete pjese jane perdorur shume metafora dhe krahasime te cilat e bejne veprën edhe me te larmishme. Vihen re edhe pershkrimet e zgjatura deri ne detaje te hollesishme. Fundi i prozes eshte tragjik pasi përfundon me vdekjen e Samandes, personazhit kryesor.

## Rrjedha mjegulle

Darjana TALLAKU

Shoqëria shqiptare përballet me problemet e mjerimit dhe varfërisë. "Bari i ujkut" i Istref Haxhillarit e kundron jetën edhe përmes shpirtit të trazuar të atij që vuan problemet ekzistenciale.

Ai ka pasqyruar jetën e një njeriu të harruar. Duket i flakur në vetminë e kohës. Danishi i urtë, mbyllur në punën e tij është pre e varfërisë. Ajo e ka bërë atë të humbë sensin e kohës. Nuk ka mbe-tur i njëjti Danish. Ai dikur punonte roje në një konvikt dhe i dukej se kishte gjithçka. Gumëzhitja e fëmijëve, punët mes tyre, rrihnin flatrat ndaj i gazmonte shpirti.

Dikur njeri që e donin, tashmë i kthyer në të vetmuar. Danishi i thyer, i plagosur nga jeta, i harruar nga të tjerët dhe i lënë në mëshirë të fatit, këlthet me hesh-tjen e tij dhe dëgjojnë vetëm ata me pe-jzat e shpirtit ndehur nga dhimbja.

I lodhur, i raskapitur nuk donte t'a dinte për njeri. Mes tyre mbytej nga përbuzja, thua ky të ketë bërë gjithë mëkatet e kësaj bote. Por edhe kur dikush i afrohej, ai vazhdon-te punën e tij sikur të mos kish njeri. Nuk donte ta shqetësonin, i pëlqente vetmia ku e kishte flakur harrësia. Thelbi i kësaj proze u pëshpërit njerëzve se mjerimi dhe varfëria e bëjnë njeriun të ndihet i padobish-ëm dhe të mos e vlerësojë më veten. Har-rimi të nxin në vetmi, të mërr mendje e shpirt, të than e ngrin.



# Dy të vërteta që i mbuloi me dhe diktatori në 4 prill 1944



Nga Egerem KALANXHI

**S**iç dihet, më 7 Prill 1939 Italia fashiste pushtoi atdheun tonë dhe si e tille, mbas pushtimit, Italia krijoi administratën e saj shtetërore dhe vendosi kuësurat të cilat verifikuan se cilat ish patriotët që dhe familjet patriotike që t'i digite, t'i persekutonte dhe t'i burgoste, pasi ato me siguri do të ngriheshin, do të organizoheshin ne lufte për të mbrojtur atdheun dhe për të çliruar nga pushtimi i Italisë fashiste.

Një nga këto familje ishte edhe familja e Tele Baçit, nga fshati Çezmë e Vogël, komuna Trebinje, në Mokrës e Sipërme, që italianii i dogji shtëpinë dhe i konfiskoi gjithë pasurinë dhe me pas e burgosi. Se kush ishte Tele Baçi dhe pse e burgosi Italia fashiste do ta shpjegoj më poshtë por fillimisht do të shpjegoj se kush ishte fisi i Baçlarëve, para pushtimit fashist që ne vitin 1920.

Tele Baci ishte nipi i Brahim Baçit, i cili, sipas dokumenteve të nxjerra nga Arkivi i Shtetit, ka gene trimi i Mokrës se që ka luftuar vite me radhë kundër serbëve. Në Serbi i thërrisnin Brahim Krajlji, sepse ishte trim dhe kishte merita për luftën që bënte kundër tyre. I njohur është fakti se ai zbuloi dhe shpartalloi Muzhakët e Polisit të Librazhdit të cilët paguheshin me rroge nga Serbia. Në një letër që i shkruan Aqif Pashë Elbasanit i shpjegon për fitoren që kishte korrur kundër serbëve ku i raportonte se nga serbët u shpartalluan dhe mbetën katër të vrare e u kapën tetë robër, kurse nga tanët u plagosen vetëm dy vetë.

Pavarësisht se serbet futeshin brenda kufijve të Librazhdit, të Mokrës, të Pogradecit dhe të Korçës, deri në Prespe, Brahim Baci me forcat që i organizonte me se miri, si strateg, me anë të luftës i nxirrte jashtë kufijve. Në Fondin 149, dosje 76, viti 1920 në Arkivin e Shtetit ka një sërë dokumentesh me vlerë. Të moshuarve, e sidomos gjyshit tim, i rrija shumë afër dhe dëgjoja me vëmendje, tepër i përqendruar kur fliste për luftën që kishte bërë Brahim Baçi kundër serbëve. Gjithmonë ai përsëriste: "Eh ore bir, në Serbi Brahimin i thërrisnin Brahim Krajlji!". Ja ç'më tregonte gjyshi:

"Një fshatar nga Tushemishti, Koci Tasi Tushemishti, kish vajtur në malin e Thate me gruan dhe dy djemte për të bërë dru zjarr apo zahire për bagëtinë, brenda kufirit tonë, 200 metra larg kufirit të tyre, kur u qëllua dhe u plagos nga agjenti i serbëve i cili quhej Zafir Tushemishti, i arratisur në Serbi. Ashtu siç tregon edhe dokumenti i nxjerrë nga Arkivi i Shtetit (Fondi 157, dosje 28) këtë vrasje serbet e paguan ne luftimet që zhvilloi Brahim Baçi kundër tyre. Rasti tjetër ishte kur serbet rrethuan natën shtëpinë e tij e i thirren të dorëzohej, por ai u përgjigj se do të dorëzohej se nuk kishte nga të shkonte dhe ndërkohe organizoi shpejt e shpejt forcat që mbante me vete, nipat, vëllezërit e luftëtarë të tjerë të Mokrës. Te porta vendosi Tele Baçin, të tjerët nëpër dritare e frëngji, ndersa vetë, pasi u dha porosinë që të hapnin zjarr pas tij, neper oxhakët e dhomës, doli mbi çatinë e shtëpisë e hapi zjarr, i shoqëruar edhe nga të tjerët. Serbet u tmerruan se u erdhi e papritur përgjigja që u dha trimi Brahim Baçi me shokë. Më pas erdhën në ndihmë edhe banorë nga fshatra të tjerë si nga Çezma e Madhe, Hondisht, Dunica, Trebinja dhe Pleshishti. Lufta përfundoi me shpartallimin e serbëve që veç të tjerëve iu vra edhe komandanti në vendin e quajtur Korja e Çezmës, në një bregore, te guri zhurak.

Një ditë, në një kafene të Tiranës se Te,



kërkova leje dhe u ula në një tavoline me një të panjohur. Ne muhabet e sipër, pasi u prezantuam se nga jemi, kush jemi e me ç'punë jemi marrë, ai me tha se kishte punuar shofer në një ekspeditë topografike ushtarake në kohën e Partisë së Punës. Pasi e mori vesh që unë isha nga Pogradeci, me tregoi se ne malin e Homezhit, në jug të Qafë-Thanës, në një pyll ku bënin hartat, gjeten kafka dhe kocka të ndryshme njerëzish. Pasi u vunë në dyshim pyeten një fshatar se ç'janë dhe të kujt janë ato kocka. Ai na tha se janë kocka të serbëve që ka vrarë Brahim Baçi, krahinar i Mokrës aty nga viti 1920, në luftimet që bënte kundër tyre për t'i nxjerrë jashtë kufijve të vendit tone.

Një prove tjetër që vërteton me se miri se kush ka gene Brahim Baçi, është nipi i Tele Baçit, Hyqmet Ismail Baçi, i cili vdiq në dhjetor të vitit 2008. Ai merrej me tregti perimesh dhe kur kishte vajtur për blerje mallrash në Maqedoni, një i panjohur e kishte pyetur në Maqedoni se nga ishte e si e qanin. I ndjeri Hyqmet i kish treguar emrin e mbiemrin dhe personi i kishte thënë:

- Po pse more, prej fisit të Baçëve je ti? Bën mire të ikësh se po e morën vesh se je Baç, të zhdukën menjëherë, se atë që i ka bërë Serbit Brahim Baçi, nuk ia ka bërë kush tjetër, as perëndia vetë!

Prova me e sakte që vërteton me se miri se kush ka gene Brahim Baçi, është dhe fotografia ku se bashku me shoqëruarit dhe me oficeret bullgarë, shihet ulur me pushkë ndër gjunjë edhe Brahim Baçi. Vlen të përmendet që në takimin që patën bullgarët me Brahim Baçin në ato kohë, i ofruan gradën e gjeneralit por ai nuk e pranoi pasi ata kishin qëllime për ta korruptuar. Po trimat e Shqipërisë nuk e hanin kurrë sapunin për djathë.

Brahim Baçi jetoi i verbër gjatë dhe mbas çlirimit të atdheut, por këtë hero, pasardhës të Skenderbeut nuk e përmendi njeri, pasi ishte xhaxhai i Tele Baçit.

\*\*\*

Po cili ishte Tele Baci e pse u pushkatua nga diktatura? Cili ishte aktiviteti i tij ne krye te mokrareve që i donte dhe e donin aq shume? Cili ishte funksioni i tij deri me 4 Prill 1944 e çfarë sakrifice beri ai në lufte kundër fashizmit Italian për çlirimin e atdheut e për një Shqipëri të lirë e demokratike?

Dita kur ai u pushkatua, në 4 prill 1944 koincidon me një ditë për të cilën ai endërroi dhe luftoi aq shume. Pas 65 viteve, më 4 prill 2009, Shqipëria u bë anëtare e NATO-s dhe aty u realizua ëndrra e tij për të cilën ai dha

gjakun.

Ashtu siç kam shkruar në fillim të artikullit, Italia fashiste Tele Baçin e burgosi, i dogji shtëpinë, se ishte familje patriote. Por Tele Baçi theu hekurat, doli nga burgu, dhe formoi çetën e parë me mokraret dhe kreu aksionin e parë në Shqipëri kundër Italisë fashiste. Dogji, shkatërroi dhe konfiskoi posten e xhandarmërisë italiane në Shën e Premte te Lenies së rrethit të Gramshit të cilën e vertetojnë dokumenta të nxjerra nga Arkivi i Shtetit si dhe nga shkrimi i vete diktatorit Enver Hoxha në veprën e parë apo te dyte i cili thotë se aksionin e parë kundër Italisë fashiste e ka bërë çeta e Mokrës. Ne te njejtën kohe, nuk përmend Tele Bacin si komandant të Çetës sepse e pushkatoi me pabesi dhe poshtërsi në 4 Prill 1944.

Pavarësisht periudhës katërqind e ca vjeçare, Brahim Baçi me luftën disa vjeçare që beri kundra serbeve jo vetëm i shpartalloi dhe i shporri jashtë atdheut, jashtë kufijve të vendit tone. Pasardhësi i Brahim Baçit, Tele Baçi mbas vrasjes se Reshit Çollaku u bë komandant i batalionit "Shqiponja" e me pas komandant i batalionit "Reshit Çollaku", te cilin e drejtoi më së miri në lufte kundër fashisteve italiane. Tele Baçin e donin shume mokraret dhe për rrjedhojë ai kishte influence te madhe në zone. Ja çfare i tha Tele Baci ne nje takim qe pati me Mehmet Shehun, komandantin e Brigadës së Parë: Ta ruajmë popullin te mos na vritet dhe digjet se është popull i varfër, nuk ka bukë te haj jo me te tjera gjëra". Ndersa Mehmet Shehu iu përgjigj se ti dashke një plumb se sa me shume te vritet dhe te digjet ky popull aq me shume simpati fitojmë ne për luftën, ndaj ne 04 prill 1944 atë e pushkatuan. Telja bashkëpunonte me krerët e Ballit, me Dulen e Alarupit, me Bajram Trebinjenën, Nias Çezmen, Haki Blloshmin dhe Rraman Zvarishtin.

Ja çfare shkruan komanda italiane për Tele Baçin kur ai dogji dhe shkatërroi e konfiskoi posten e xhandarmërisë në Shen e Premte të Gramshit: "Të kapet kaçaku Tele Baçi, te identifikohen edhe pese te tjerët dhe te ekzekutohen me gjyq special ushtarak" (e vertetuar me dokumentin nxjerre nga Arkivi i Shtetit, dosje 285 fondi 152 viti 1942). Ndersa kur e pushkatuan më 4 Prill 1944 kuësura e Korçës i shkruan asaj të Pogradecit: "Ju bëjmë me dije se komunistet kane pushkatuar Tele Baçin ne mosbesim. Nuk dihet për fatin e të vëllait Ismail Baçit dhe dy djemve te tij Naim dhe Sadik Baçi, pasi janë arrestuar ndersa populli është indinjuar pa mase për vrasjen e tij" (viti 1944 dokument i nxjerre nga Arkivi i Shtetit, Fon-

di 154, Dosje 345). Kur ka dhënë urdhër diktatori për te pushkatuar Tele Baçin ka dhënë porosinë: (vërtetuar ne veprat e ti nr. 1-2) "Kini kujdes kur te pushkatori Tele Baçin se ka influence te madhe në Mokrë dhe te mos ndodh ndonjë e papritur!". Por ajo ndodhi. Populli i Mokrës u indinjua shume, batalioni u shkatërrua, mokraret u shpërndanë nëpër shtëpi. Me vonë u mblodhën me komandant Etem Haxhinë, që u pasua nga komandant Suat Leskoviku, një dashakeqes i mokrareve, i cili bashkëpunonte me Tuk Jakovën. Një dite para pushkatimit Tele Baçi, bashke me batalionin qe komandonte ishte ne fshatin Homçan të Mokrës, ndërkohe që Shtabi i Brigades së Pare ishte në Velçan të Mokrës i dërgoi korrierin me një leter ku e lajmëruan qe ai te shkonte ne Velçan ne mbledhjen e Shtabit. Mbasi mori lajmin ai u nis bashke me batalionin, ndersa i biri, Sadiku e kish paralajmëruar qe te mos shkonte ne Velçan, se nuk i dukej i mire ky lajm deri sa te sqarohet se çfare behej kjo mbledhje. I ati i tha qe te shkojë pasi s'ka pse te ketë ndonjë gjë te keqe. Baza e shtabit ishte ne shtëpine e Mehmet Agos së Velçanit, dhe perveç një të afërmi te tij qe kishte me vete Telja, te tjerët u shpërndane nëpër baza te tjera te fshatit. Ne mbremnje vonë pasi i kishin arrestuar të vëllain, Ismailin dhe dy djemte Naimin dhe Sadikun, i vendosen fshehurazi dhe me një pabesi të poshter dhe i vunë mitralozin në dere të dhomës ku gjasme do te behej mbledhja, i thane te dorëzohej por ai nuk pranoi. Por i afërmi i tij i afrohet e i thote që të dorëzohen, se ish in arrestuar të gjithë, se do te vriteshin të gjithë. I thanë se nuk do ta vrisnin por vetëm do ta gjykonin për ca gabime qe kishte bere, e duke përfituar nga mosha e tij e re e kapën dhe e lidhën. Mbasi u zhvillua gjyqi special e pyeten se çfare ka për te thënë, ai iu përgjigj se e kishin prere ne bese, se nese ish in burra duhet ta thërrisnin ne duel, se vetëm qeni te ha ne pabesi siç po me hani ju mua, dhe e fundit ishte porosia qe la per Faik Kalanxhin qe te mos e varrosin në Velçan por ne Çezmën e Vogël, ne fshatin e tij. Faiku, nipi i tij (njëkohesisht i ndjeri babai im) e mori të ngarkuar në kalë dhe e varrosi ne Çezmë e Vogël, ne fshatin e tij.

Kur e pushkatuan, i ranë me mitraloz, por trimi ngriu në këmbë, nuk u rrezua. Afër i kish vajtur Misto Treska dhe i ra me revole ne kokë e trupi i tij u shtri përtokë. Te vëllain Ismail Bacin dhe dy djemte e tij i morën me vete dhe i çuan ne Shtab të Përgjithshëm në Lavdar të Oparit. Atje vajti i vëllai i gjyshit, Nexhip Ago, të cilin e thirren për të dalë garant dhe ashtu u bë. Ai i garantoi qe ata nuk do te bëjnë asnjë levizje me te vogel dhe i liruan. Erdhën ne fshatin e tyre e iu shtruan punës me kokën ulur ashtu siç e kërkonte diktatura. I vëllai i Teles, Ismaili ishte i plagosur në gju gjate luftës kundër fashizmit dhe çalonte, ndaj mori pension invaliditeti të cilin me pas ia hoqën.

Urdhrin për pushkatim e Teles e dha diktatori Enver Hoxha e arsyeja kryesore ishte se ai ishte nipi i Brahim Baçit qe kishte luftuar kunder serbeve ne 1920 e ne vazhdim per disa vjet me rradhe dhe nuk i lejoi te realizonin synimet e tyre për kufijtë e Shqipërisë nga Elbasani deri ne Prespe. Gjate luftës në Shqipëri Tito dërgoi dy pseudokëshilltarë, te cilet ishin agjentet e tij, Dushan Mugosha dhe Milladin Popoviçi. Tito ishte agjent i Stalinit për Ballkanin ndersa Enver Hoxha ishte agjent i Titos per Shqipërinë. Kur Dushan Mugosha e Milladin Popovici moren vesh se Tele Baci, nipi i Brahim Baçit ishte komandant i batalionit te Mokrës dhe kish luftuar serbet i dhane urdhër diktatorit për ta pushkatuar dhe ai ashtu beri.

Burrat e Mokrës i mbaj mend se jam rritur vete në Moker. I pari vinte Brahim Baci, me pas Reshit Çollaku Muharrem Çollaku, Tele Baçi, Cene Mani, e Hekuran Krasniqi qe u vra ne provokacionin e 2 gushtit në lufte kundër grekut, ndersa burra të vjeter me zë ishin Nexhip Ago i Hondishtit, Liko Gjona nga Lakteshi dhe Murati i Haxhiut nga Slatina e Mehmet Ago me Elmas Lufon nga Velçani i Mokrës, të gjithë këta ishin nderi dhe lavdia e Mokrës.

(vijon)



TË NJOHIM E NDEROJMË FIGURAT E SHQUARA TË KOMBIT!

# Inxh. Petraq Pekmezi, "Nderi i Kombit"

Dekoruar me Dekret të Presidentit të Republikës Nr 6359 datë 09. 12. 2009, me Urdhërin e Lartë "Nderi i Kombit". Motivacioni: "I Martirizuar nga terrori komunist, për shkak të besimit në Demokracinë Perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore"

## Nga Koço PIHONI

Po kush e cila është jeta e veprimtaria e z. Petraq Stavre Pekmezi!

Petraq Pekmezi u lind në Pogradec më 15 Maj të vitit 1901. Rrjedh nga një familje zanaçinsh të vjetër, rrobaqepës, që nga i gjyshi Spiro Llakmani dhe i ati Stavre Pekmezi, i cili kishte pesë fëmijë, dy vajza e tre djem: Artemisi, Mamica, Petraqi, Borizi, Trajani. Ishte një familje me tradita atdhetare e arsimdashëse. Petraqi, mbas mbarimit të shkollës fillore në vendlindje, vazhdoi shkollën unike në qytetin e Ohrit, ku u dallua për përparime të larta në mësim, veçanërisht në shkencat e sakta. Këto rezultate të shkëlqyera e kënaqën të ungjin e tij, Dr. Gjergj Pekmezit, i cili ishte për shumë kohë, gati për 30 vjet, në Vjenë të Austrisë me detyra nëpunës, përkthyes në perandorinë Austro - Hungareze, njëherësh gjuhëtar e albanolog, si dhe Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë në Vjenë për 13 Vjet. Ka qenë edhe shefi i Katedrës së Gjuhëve Orientale në Universitetin e Vjenës. Emrin e këtij dijetari shqiptar mban kjo katedër edhe sot në Vjenë, ku prehen eshtrat e këtij patrioti të madh, që nderi e do të prehen në atdheun e tij, për të cilin punoi aq shumë, jo në Vjenë të Austrisë. Me mbarimin e shkollës unike, Petraqi shkoi dhe vazhdon studimet e mesme e të larta për Inxhinieri Hidro-Teknike në Universitetin e Vjenës, nën kujdesin atëror të ungjit të tij Dr Gj. Pekmezit. Ishte një nga ata studentët që u diplomua shkëlqyer, duke u bërë edhe pionieri, apo dallëndyshja e parë e Hidroteknikës të vendin tonë. Gjatë viteve që studjoi në Vjenë, ka qenë nga studentët intelektualë më aktivë të shoqërisë studentore "Albania", shoqëri atdhetare, patriotike e themeluar më 10 mars 1918 me organin e saj të shtypit "Djalëria", e cila kish për kryetar studentin për mjekësi, Dr. Jani Bashon, dhe ky bashkëqytetar i tij. Petraq Pekmezi ishte i zgjedhur në organin drejtues të kësaj shoqërie, i cili shkroi e mjaft shkrime në organin e saj të shtypit, që e afirmuan atë si njeri vizionar e largpamës. Në shkrimet e tij evokohej edhe për njohjen e vlerave të popullit shqiptar e nevojën që ka ky vend për njerëz të ditur për të përparuar e për t'u zhvilluar. Petraqi zotëronte disa gjuhë të huaja si gjermanisht, frëngjisht, italisht, greqisht, maqedonisht.

Selia e Konsullatës së Shqipërisë e shtëpia e Dr. Prof Gjergj Pekmezit në Vjenë ishte e hapur për dhjetëra e dhjetëra bashkëpunëtorë e patriotë shqiptarë, përmenden emra të tillë si Barjam Curi, Hasan Prishtina, Rexhep Mitrovica, Fan S Noli, Faik Konica, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Moisiu etj, të cilët lanë gjurmë tek ai dhe në edukimin patriotik me atdhetarizmin e tyre. Aty u njoh me shumë dijetarë të kohës, profesorë të Universitetit të Vjenës, T. Ippen, F. Nopca. Ka pasur njohje e miqësi direkte me fizikantin, gjenium Albert Ajshajtnin.

Gjatë viteve të studimit, njihet, dashurohet e lidhet në martesë në vitin 1922 me studenten austriake Ketrin Morr, e diplomuar për Ekonomi. Nga kjo martesë ata suallën në jetë katër fëmijë, dy djem e dy vajza: Viktorin, Stavrin, Gerti e Lilianën.

Në vitin 1923 mbasi përfundoi studimet, kthehet në atdhe. Me gjithë ofertat që pati për të filluar punë në disa institute në Austri, ku nuk i mungonin as mbështetja e familjes së bashkëshortes, por ai ishte kategorik në vendimin e tij, duke pasur parasysh nevojën që kish atdheu i tij, Shqipëria, e cila ishte e zhytur



në errësirë. Dhe ai e kuptonte misionin historik që ai dhe djalëria e studiuar në perëndim duhej të luante për vendin e tyre, për Shqipërinë.

Në verën e vitit 1923, pas kthimit në atdhe fillon punë. Krijon shoqërinë "Puntoria Pekmezi" me qendër në Korçë e Pogradec, me aktivitet, "Shitje pajisje Hidro-teknike dhe instalimin e tyre" për zhvillimin e këtij aktiviteti ishte lidhur me shoqërinë konçensionere italiane "Flaviola", e cila siguronte furnizim për pajisje sipas porosive. Kjo shoqëri luajti një rol të rëndësishëm në futjen e teknologjisë së kohës e sjelljen e të resë në këtë fushë. Inxhinier P. Pekmezi i sugjero parësisht të qytetit të tij Pogradecit, të krijonin një shoqëri aksionare për të bërë të mundur përballimin e financimin e një projekti që kish menduar ai, për elektrifikimin e qytetit të Pogradecit e më pas e për shumë qytete të vendit. Në krye të kësaj nisme në këtë qytet u vu Xhevat bej Starova, me një grup aksionarësh të tjerë si Gjokë Vakoni dhe dhjetëra afaristë e biznesmenë të qytetit e shumë fise të qytetit, të cilët bënte të mundur sigurimin e nevojave financiare për të bërë të mundur "elektrifikimin e qytetit të parë në Shqipëri" dhe vendlindjes të tij, që më pas shërbeu si pikë nisje, edhe për qytete të tjerë të vendit ndër to dhe për Ohrin.

Menjëherë inxhinier Petraq Pekmezi iu përvesh me përkushtim punës për bërjen e projekti për të parin, Centralin hidrotermik në Shqipëri atje në Kabash të Katjelit në atë vëndbanim të hershëm Ilir të Enkelejve dhe gjatë viteve 1926-27 projektoi, ndërtoi, importoi pajisjet, bëri montim- instalimin e tyre, shtroj disa km rrjet linjë me telat elektrikë dhe bëri instalimin e tyre në gjithë institucionet e çdo familje të qytetit.

Me grupin e specialistëve të përgatitur prej tij që ishte "Puntoria Pekmezi" dhe realizoi një nga ëndrrat e tij madhore, duke përligjur dhe shumë vite studimi të kryera në një nga universitetet më të mira të kohës, duke i kthyer në "relika" ndriçimin me pishë, me qiri, kandilka a llampa me vajguri. Besoj se ky ishte shërbimin më i madh i bërë në histori qytetit të tij të dashur. Duke i sjellë këtë "trofe", ai solli arritjen më të madhe, më emancipuese të njerëzimit për kohën, "dritën", e prodhuar me energjia ujore dhe duke e bërë qytetin e Pogradecit "qytetin e parë të dritës" dhe duke fituar njëherësh urimin që dilte nga zëmra e gjithë banorëve të këtij qyteti: "Ju bëftë dita njëmijë e i ndritë dhe shpirti këtij Njeriu!". Kjo mund të

përkthehet dhe si një "shpërblim" që prodhoj ajo hapja e shkollës në gjuhën shqipe, në këtë qytet pas shkollës të parës në Korçë ku morën mësimet e para dhe të gjithë ata personalitete si Dr. Basho, Lasgushi, P. Pekmezi, M. Pasko, Dh. Pasko, R. Çollakun, T. Naco e shumë e shumë të tjerë më pas. Në vitin 1928 inxhinier P. Pekmezi e transferon aktivitetin e tij "Puntorinë Pekmezi" në Tiranë, ku kontribuoi në shumë projekte të infrastrukturës në dhënie e një fizionomie të re, Tiranës, si kryeqyteti i ri i Shqipërisë, i caktuar prej disa vitesh.

Gjatë atyre viteve ai ka qenë edhe këshilltar i Mbretit Zog për problemet e hidroteknisë dhe shoferi "diplomatik" për rastet kur udhëtonte jashtë vendit, kjo dhe për shkak të njohjes së disa gjuhëve dhe kulturës perëndimore që ai kish marrë. Mbas pushtimit fashist të vendit vëllezërit Pekmezi u lidhën ngushtësisht me lëvizjen e Luftën Nacional Çlirimtare kundër okupatorëve, ku "Puntoria Pekmezi" ka qenë bastion, bazë ilegale e luftës kundër okupatorit fashist, ku i vëllai i Petraqit, Trajan Pekmezi ishte një nga aktivistët kryesorë të njësiteve guerile e një nga anëtarët më aktivë të qarkorit të PK për Tiranën. Dhe koordinatori kryesor që mbante lidhje me njësitet partizane të batalionit të Mokrës heroike me komandant Reshitin legjendar, deri në fund të jetës së tij. Dhe vëllai i tyre Boris Pekmezi pjesëmarrës në shumë aksione partizane e pjesëmarrës në luftën heroike të Pojskë në këtë betejë ra heroikisht dhe Komandanti i saj Reshit Çollaku, Hero i Popullit. Pushtimi i vendit nga nazistët gjermanë e gjeti në një pozicion të vështirë inxhinier Petraq Pekmezit. Për arsye se ai ishte shkolluar në Austri, ishte zotëruesi i gjuhës Gjermane e kish marrë edukim perëndimor dhe kish dhe kishte bërë e lidhje martesore që e bënin atë personi e "duhur" për t'u besuar nga komanda Gjermane që ky të vihej në shërbim të Gestapos.

Kjo ishte arsyeja që ai u thirr nga komandanti i tyre, Gjenerali Fitzthuni që kish kryer studimet dhe ai në Vjenë e kish pasur njohje. Ai i afroq kërkesën inxhi. Petraqit për t'u vënë në shërbim të tyre. Kjo kërkesë u refuzua fillimisht, duke u përpjekur ta bindë gjeneralin, se ai nuk kish as njohuri nga arti ushtarak dhe se ai ushtonte aktivitet në specialitetin e tij. Gjenerali Fitzthun me njerëzit e tij i dhanë 24 orë kohë të mendohej e të vinte të njoftonte për vendimin e marrë? Petraqi shkoi e bisedon me të vëllain Trajanin i cili ishte anëtar i qarkorit të Partisë Komuniste, ai pasi e dëgjoj i thotë Petraqit? Ju si keni menduar të veproini, si do bëni? Dhe përgjigja ishte se ai kërkon ta ndihmonin, donte të dilte në mal. Trajani i thotë të presë e shkoj menjëherë e kërkon takim me shokët e qarkorit të partisë dhe e bisedon këtë problem e afatin kohor që i kishin lënë. Shokët e Qarkorit të partisë, pasi e diskutuan, thanë: "Ne ku ta gjejmë që të kemi njeriun tonë, në strullfillen e armikut", prandaj urdhëruan që ta pranojë detyrën, si shërbimin më të mirë që mundet t'i bënte vendit. Për të garantuar sigurinë e jetës nga ana e qarkorit u pajis me një "distiktiv" që e bënte të pa prekshëm, në rast se në rrethana të ndryshme kapet nga forca partizane në gjithë territorin e vendit. Mbas këtij vendimi, ai paraqit në Komandën Gjermane ku konfirmon se kishte vendosur të pranojë detyrën dhe filloj punë si përkthyes më gradë toger SS. Shumë shpejt për aftësitë e tij, ai u bë njeri i besueshëm e i vlerësuar nga autoritar në Komandën Gjermane.

Ky personalitet, është vlerësuar aso kohe nga qarkori, si njeriu "shtylla" e suksesit në gjithë luftës kundër hordhive naziste, ai ka dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm, të pallogaritshëm në dhënie informacioni, logjistikë ushtarake (hartave)

etj, si dhe realizimin në rastet e nevojshme të ndërmjetësinë, ndërmjet përfaqësuesve të Shtabit të luftës për çlirimin e Tiranës dhe përfaqësuesve të lartë të Komandës gjermane për çështje shumë të rëndësishme. si dhe shpëtimi nga ekzekutimi i dhjetëra qytetarëve e partizanëve të kapur dhe burgosur në burgjet nga Nazistët në bashkëpunim me forcat e ballit, si në qytetet Tiranë, Elbasan, Prishtinë, Strugë dhe ndërhyrjen në shpëtimin nga djegia e shkatërrimi i fshatrave të tëra, këtu veçoj dhe fshatin e origjinës së tij Tushemishtin e qytetin e Pogradecit dëshmitarë të atyre ditëve, ish partizanë të kapur e burgosur nga forcat gjermanoballiste, sot veteranë të luftës që jetojnë e sot në Pogradec, shokët Gaço Naço, Sandër Mile etj dëshmojnë edhe sot për bashkëqytetarin P. Pekmezit për atë, duke e vlerësuar, Atdhetar i përmasave të mëdha, që e ka merituar që në atë kohë, ti jepej titulli Hero i Popullit. Për gjithë ato shërbimet e mëdha të kryera e për rëndësisë e veçantë për vendin e vlerë të pallogaritshme të veprimtarisë së tij, ku unë duhet të veçoj, nxjerrjen e "Hartave tepër sekrete" nga Komanda e Gestapos, veprime që për cilin do tjetër ishin të pa mundura, ku rreziku për jetën e tija, ishte gjëja më e pa përfillur. Në ato harta, ishin të qartësuar objektet kryesore që ishin të minuara nga gjermanët, që do hidheshin në herë në ditë e luftës për çlirimin e Tiranës. Ai informonte Qarkorin e Shtabin e Përgjithshëm, për këtë rrezik e për pasojat katastrofike, në qoftë se do kryen veprime ushtarake, pa u bërë çminimi i tyre për të mos vepruar, pa u marrë masa e pa u bërë më parë çminimin e tyre. Ishte Petraq Pekmezi ai që realizoj takimin "tepër Sekret" "e ndërmjetësimin e bisedimeve midis përfaqësuesit të Shtabit të Përgjithshëm, Mehmet Shehu dhe përfaqësuesit të lartë, oficerit Madhor të Komandës Gjermane, takim që u zhvilluar në fshatin Shish- Tufinë të Tiranës. Atje u bë "një marrëveshje dypalëshe historike" mbase, midis dy krerëve, përfaqësues të palëve ndërluftuese. Në këtë marrëveshje, bëhej fjalë për një pakt mos sulmimi nga forcat partizane, të autokolonave të ushtrisë gjermane të cilat kërkonin një rrugë kalimi, tashmë në tërheqje, me qëllim dhe të mos dëmtimin e të dy palëve, sikurse u veprua në fakt, ndërkohë kur lufta për çlirimin e Tiranës, ishte më kulmin e saj, forcat gjermane tërhiqeshin lehtësisht në drejtim të Vorës dhe prej andej vazhdonin drejt Shkodër për të kaluar më pas në Mal të Zi e prej andej më tej.

Marrëveshje kjo që dyshohet si shkak që M Shehu më pas të urdhërojë, eliminimin fizik të këtij personaliteti që ndërmjetësoj, dëgjoj dhe përktheu gjithçka që u tha e u vendos atje. Kur kishin mbetur vetën 4 - 5 ditë nga e çlirimit të Tiranës, dhe e festimit të ditës së kësaj fitoreje historike për gjithë popullin, ku Petraq Pekmezi kishte pjesën e tij të "luantit", fatkeqësisht nuk ndodhi kështu. Pabesisht njoftohet se e kërkon shah Mehmet Shehu në vend ndodhjen e Shtabin të Përgjithshëm të luftës për çlirimin e Tiranës. Fatkeqësisht, ajo ishte dita e fundit e jetuar e atij njeriu, e atij njeriu që ishte "legjenda e përpjekjeve për çlirimin e Tiranës." E vërteta e kësaj ngjarje do merrej vesh, do të zbardhej shumë vjet më vonë. Në vitin 1977 u muar vesh saktë nga deponimi i personit që kish marrë pjesë në ekzekutimin e tij me pushkatim, dora vetë, Gjeneral Bako Dervishi, i ka deponuar dhe i ka lëshuar "Dëshmi" më shkrim, nipit të Petraq Pekmezit, Timoshenko Pekmezi, person i interesuar për zbardhjen e të vërtetës, ku ai, Bakua, (vijon në faqen 8)



## Inxh. Petraq Pekmezi, "Nder i Kombit"

(vijon nga faqja 7)

... në këtë dëshmi me shkrim, dëshmon se ai, së bashku me dy shokë të tjerë partizanë, kishin marrë urdhër gojor direkt nga Komadantit i Përgjithshëm i forcave për Çlirimin e Tiranës, Mehmet Shehu për ta ekzekutuar oficerin "gjerman" inxh. Petraq Pekmezit, në fshehtësi të plotë, duke u mbajtur "sekret" vrasja e tij, detyrë që e kemi kryer më 12. 11. 1944 në fshatin Linzë të Tiranës. Lind pyetja, Si është e mundur të veprohej kështu, në pabesi e kundërshtim të plotë dhe të ligjit të dënimeve të kohës së luftës, kur dhe një partizan cili do të kish qenë ai, për çfarë do lloj faji, nuk mundet të pushkatohej pa ju bërë më parë, një gjyq partizan. Ky ishte ligji, Jo të veprohej në këtë mënyrë barbarësh, kundrejt një dijetari e patrioti të vërtetë, këtij "Heroi të heshtur" sikurse është quajtur dhe nga kupola e udhëheqjes po të asaj kohe, më pas në takime të mbyllura, ku është thënë e pranuar, se pa kontributin e pa shoqë gjatë luftës të "shyllës", pseudonimi i Petraq Pekmezit. Kryeqyteti ynë Tirana, nuk do mund të çlirohej me kaq pak humbje jetë njerëzish, me kaq pak objekte të shkatërruar e humbje të mëdha materiale. Ndryshe ishte menduar nga gjermanët, lufta për dorëzimin e Tiranës nga nazistët gjermanë, ishin bërë llogaritë që Tiranën do bëhej "një Stalingrad i dytë", si dëshmi edhe e dëshpërimit të asaj bishe në grammat e fundit. Tragjedi që u shmang me sukses, falë informacioneve, bashkëpunimit e ndërmetjesimeve të duhura.

Por duheshin të shkonin 65 vjet nga dita e kryerjes të këtij krimi të shëmtuar komunist. Për të fshehur tradhtinë e tyre, për t'i atribuuar poshtërsisht vetes, gjithë merita e luftës për çlirimin e Tiranës e gjithë vendit, për të "thurrur kurora trimërie e lavdie vetes e disa hienave që mbanin për rreth tyre, duke mohuar shumë sakrificë e gjak të derdhur.

Realisht vrasja e tij, duhet të ndodhte vetëm nga nazistët gjermanë a veglat e tyre ndaj atij, kurrsesi nuk duhej të eliminohej në ato rrethana, ai intelektual patriot elitar, që nuk kurseu gjithçka, por vuri në shërbim të vendit të tij, dijen, punën, përkushtimin e tija, ishte ai burrë, faktor real që solli përparim e zhvillim për gjithë shoqërinë e vendin. Ky shqiptar i vërtetë, ai nuk pranoi të qëndrojë as në Vjenë të Austrinë, duke mos e këmbëzuar atdheun e tij, me asnjë tjetër vend në botë. Por punën, përpjekjet, luftën e përkushtimin e tija për liri e për "një Shqipëri ndryshe" ju shpërblyen me një fund tragjik, më një vdekje kriminale, të pa besë, duke u përpjekur e më pas, për ta lënë në errësirë vdekjen e veprën e tija të jetuar me aq dinjitet, lavdi e nder. Por mandej edhe më keq e turp para Zotit, duke e lënë edhe pa varr, këtë bir të denjë të Shqipërisë, këtë njeri kolos të popullit që e lindi dhe që ai e desh e bëri aq shumë për atë. Duhej të shkonin 65 vjet që të "ringjallej" ai, si dëshmi kuptim plotë, mbase e ringjalljes së ndërgjegjes kombëtare e popullit tonë.

Duke e vendosur atë e të gjithë ata njerëz që e kanë dashur e kanë dhënë për Shqipërinë, në Altarin që meritojnë të jenë, në Panteonin e Kombit, atje ku duhet të jetojnë në Pavdekësi, vetëm ata njerëz që e kanë dashur dhe kanë bërë shumë punë e vepra për Shqipërinë. Janë këta heronjtë të pavdekshëm që i bëjnë nder Shqipërisë, trevave, për vlerat që kanë bartur, trashëguar e transmetojnë.

Pa dyshim, këto falënderime, shkojnë e në drejtim të Institucionit të Presidentit të Republikës për hulumtimin e vlerësimit e këtyre heronjve dhe e të tjerë personalitete të këtij Kombit që janë pjesë e tija, prandaj dhe duhet të bëjnë identitetin e popullit tonë. Për pasqyrimin e jetës e veprimtarinë e z Petraq Pekmezit i dekretuar nga Presidenti i Republikës "Nder i Kombit" po përgatitet monografia e plotë e jetës së tija, që së shpejti do dalë në botim, më rastin e 110-vjetorit të lindjes së tij.

# "NOBELISTI,, BUJAR BALLIU VLERËSON NOBELISTËT E LETËRSISË BOTËRORE

Nga Zenun FERO

Në fillim të muajit mars, autori Bujar Balliu nxjerr nga botimi librin "Nobel, Laurantët e Letërsisë,, botuar nga shtëpia botuese "ADA,, me botues Roland Lushi, recensent Istref Haxhillarin, konsulent Aida Angjo, Vasillaq Buzo, Roland Balliu, Enkelelda Olldash, me korektore letrare Elsa Balliu.

E prita me shumë kënaqësi këtë libër, se autorin e njoh, është djali i Slabinjës, me arsim të plotë, me eksperience në arsim mbi 30 vjet dhe drejtues i zgjedhur në drejtimin e Komunës Proptisht për disa vite. Një studiues i apasionuar i letërsisë dhe një mësimdhënës i mirë i lëndës së letërsisë. Nobelistët në letërsinë botërore, atë e kanë frymëzuar në punën e tij, ai i ka lexuar ata si një studiues i rregullt, ka bërë punën më të mirë, i nxjerr në një libër të veçantë me titull "Nobel-Laurantët e Letërsisë,,. E fillon me Alfred Nobel, Suedi, viti 1901, dhe e përfundon Herta Muller, në vitin 2009, Gjermani. Është një libër me përmbajtje botërore-dokumentare historike, një libër që do të jetë në bibliotekat e shumë e shumë studiuesëve e lexuesëve të letërsisë, e mësuesëve, e padagogëve, nxënësëve, studentëve e tjerë.

Libri ka mbushur një boshllëk në hapësirën shqiptare dhe botërore, natyrisht ai do të vlerësohet me kalimin e kohës nga të gjithë të apasionuarit e letërsisë dhe shkencave humane. Koordinatat e 106 nobelistëve të letërsisë botërore i gjen tek ky libër, kjo është një e vërtetë e cila ka dalë në dritë. Botimi i tanishëm i Bujar Balliu e shoh si një pjesë të shpirtit tonë për letërsinë botërore, në rrugën e gjatë të progresit, në intergrimin Evropian dhe Botëror si pjesë dhe e trashëgimisë sonë që nuk mungon.


Libri i Bujar Balliut "Nobel-Laurantët e Letërsisë,, do të jetë në çdo dorëzim të çmimit, medaljes së artë dhe diplomës, që bëhet në 10 dhjetor të çdo viti. Duam apo nuk duam ne, puna e vetë, atë e ka çuar të jetë pjesëmarrëse, me librin e vet. Ai do të përkthehet, dhe rruga e tij ka nisur drejt vendit ku japin çmimet, në Suedi. Emri i mokrait, pogradecarit, shqiptarit Bujar Balliu do të përmendet në bibliografitë e nobelistëve të letërsisë botërore.

Ky libër do të nderojë jo vetëm autorin, por edhe vendin tonë. Është e domosdoshme dhe detyrë që organet përkatëse të Ministrisë së Kulturës, duhet të përk-

Me rastin e 80 vjetorit të lindjes

## TOB, KONCERT PER NDER TE MJESHTRIT MILTO VAKO

Më 30 mars 2010 në Teatrin e Operës u zhvillua një mbrëmje muzikore me solistët, korin e teatrit, dhe Ansambli Koral Popullor, me rastin e 80 vjetorit të lindjes së dirigjentit Milto Vako. Pas mbarimit të studimeve në Moskë, Vako ka drejtuar korin e Liceut Artistik "Jordan Misja". Nga viti 1964 ka drejtuar për katër vjet korin e Teatrit të Operës dhe në vitet 1968-1973, ka qenë udhëheqës artistik i Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore. Pas viteve 1990, ka punuar në Akademinë e arteve si pedagog i korit dhe më pas si drejtues i kadetrës së dirigjimit. Aktualisht është pedagog i dirigjimit dhe dirigjent i korit të vajzave.



thejnë dhe ta dërgojnë në Suedi e shumë vende të tjera të botës. Është gjë e veçantë, ai ka vlera jo vetëm për Shqipërinë por edhe për gjithë botën, në Evropë, Azi, Amerikën Veriore, Jugore e Afrikë.

Në këtë libër janë 106 nobelistët të letërsisë botërore, Europa ka 79, Azia 6, Amerika Veriore 13, Amerika Jugore 4, Afrika 4, në përqindje janë Europa 74.5 përqind, Azia 5.6 përqind, Amerika Veriore 12.64 përqind, Amerika Jugore 3.7 përqind.



## Muntaz Dhrami, pas Lasgushit, një monument për Mitrushin

Dhimiter Pasko apo siç njihet nga të gjithë shqiptarët, Mitrush Kuteli, do të ketë tashmë për herë të parë një monument. Është pikërisht skulptori, Muntaz Dhrami i cili pas një punë të gjatë, bën publike tashmë personalitetin të cilit ia kushton. Ai tregon se ka punuar për gati dy vjet dhe tashmë, kur imazhi është i qartë ai zbulon se bëhet fjalë për prozatorin e njohur shqiptar, Mitrush Kuteli. Skulptura është rreth 3 metra e lartë, ndërkohë që Dhrami është gjithashtu autor i monumenteve edhe të figurave të tjera të njohura shqiptare si, Lasgush Poradeci apo Ali Pashë Tepelena. Më tej skulptori, tregon se vepra do të vendoset në Pogradec pranë monumentit të Lasgush Poradecit. Por, pas veprës që iu kushtua kështu një nder prozatoreve me të shquar të letërsisë shqipe, skulptori shpreh se ka ende shumë figura të cilat janë lënë në hije dhe që sipas tij meritojnë të tilla monumente. Muntaz Dhrami e ka nisur karrierën e tij që vitet '60, është autor i një sere veprash të njohura e bashkautor i monumentit të pavarësisë në Vlorë apo "Nënës Shqipëri" në Tiranë. Gjithashtu ai është laureat i çmimit të nderit në Bienalen e Aleksandrisë (1964), laureat i disa çmimeve dhënë nga shteti Shqiptar si dhe mban titullin "Skulptor i Popullit" (1978).

## Vepra poetike e Lasgush Poradecit promovohet në vendlindje

Vepra e plotë poetike e Lasgush Poradecit, botuar me besnikëri ndaj dy varianteve të Bukureshtit dhe shënimeve që vetë autori kishte bërë në anë të faqes, u promovua ditën e premtë date 9 prill në një ceremoni të organizuar në Pogradec. Botimi i përgatitur nga dy vajzat e poetit, Kostandina dhe Marie Gusho, financuar nga Ministria e Kulturës, shoqërohet me një parathënie të shkruar nga vetë poeti, e pabotuar më parë.

Në ceremoninë e përzurimit ishin të pranishëm qytetarë pogradecarë, dashamirës të veprës së tij letrare dhe ministri i kulturës z. Ferdinand Xhaferi, drejtori i kulturës në këtë ministri, poeti Bardhyl Londo, kryetari i bashkisë Artan Shkëmbi etj. Pas fjalës pre-

qind dhe Afrika 3.7 përqind.

Nobelistët e letërsisë në Europë, janë në Suedi 7, Francë 13, Gjermani 8, Norvegji 3, Poloni 3, Itali 6, Angli 9, Belgjikë 1, Danimarkë 3, Zvicër 2, Spanjë 4, Irlandë 3, Rusi 4, Finlandë, Britani e Madhe 1, Islandë 1, Bosnje 1, Greqi 2, Çekosllavakia 1, Portugali 1, Hungari 2, Austri 1, Turqi 1, pra 79 nobelistë 74.5 përqind.

Nobelistët e letërsisë në Azi janë Indi 1, Izrael 1, Japoni, 2 Australi 1, e Kinë 1, pra 6 nobelistë 5.6 përqind.

Në Amerikën Veriore nobelistët janë në SHBA 11, Meksikë 1, Karaibet 1, pra 13, në përqindje 12.64 Ndërsa në Amerikën e Jugut janë në Kili 1, Guatemalë 1, Kolumbi 1, pra 4. Në Afrikë janë Nigeri 1, Egjipt 1, e Afrikën e Jugut, pra 4, përqind 3.7.

Nobelistët të ndarë sipas shteteve janë, Franca 13 nobelistë, 12.26 përqind, Suedia 7, Gjermania 8 nobelistë, SHBA 11, Anglia 9, Italia 6, Spanja 4, e tjerë. Vendi e parë në nobelistë e zë Franca, vendi i kulturës europiane, vendin e dytë e zënë SHBA pastaj vijnë Gjermania, Suedi e tjerë. Ky libër nuk është thjeshtë kronologji, por shumë më tepër se kaq, është meditim për njerëzit që bënë letërsi për më shumë se një shekull, mëndje të respektuar. Kritika letrare shqiptare e ka vlerësuar, gazetaret kanë vlerësuar edhe gazeta "Mokra" e ka vlerësuar. Me këtë rast uroj autorin Bujar Balliu, për këtë libër, dhe si ky duam edhe botime të tjera.